



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 3**

Rrogozhinë, më 27.02.2024 ora 13 : 30<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.776.Prot datë 20.02.2024 dhe të shkresës me Nr.776/1.Prot datë 26.02.2024, si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 12.02.2024.
- 3- Miratim i pranimi të dorëheqjes nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak të z. Ferdi Avdiu.
- 4- Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Merlin Saraçi.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës financiare të familjes së ish këshilltarit të ndjerë z. Bajazit Thaçi”.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Rrogozhinë”.
- 9- Diskutim dhe njohje me Projekt Studimin, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor, tokat bujqësore dhe inproduktive (PF) në pronësi apo përdorim të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 10- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
- 11- Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i listës së aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2024.
- 12- Të ndryshme.
  - *Kthim përgjigje nga Sektori Juridik pranë Bashkisë mbi propozimin e bërë nga dy*



*Këshilltare që fshati Kalush Nj. A Gosë të bëhet me dy kryetarë fshati.*

- *Kthim përgjigje nga Drejtoria Rajonale OSSH Durrës mbi ankesën e bërë nga Këshilli Bashkiak mbi problematikën e ndërprerjeve të energjisë elektrike.*
- *Të tjera.*

### **Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Sokol Gosa, Fatbardha Sina, Altin Tosku, Mukades Gixhari.

### **Mungojnë :**

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Lije Dedej, Erind Tosku, Hekuran Xhani, Mitat Daja.

### **Të ftuar :**

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
4. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
5. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
6. Luan Gjuzi - Përgjegjës i zyrës Juridike.
7. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
8. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
9. Endrin Ajdini - Specialist i Kulturës.
10. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.
11. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

### **Drejtton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.



- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 11- Këshilltarë. (Këshilltaret znj. Fatmira Thartori, znj. Besnike Coraj, i bashkohen në vijim mbledhjes së këshillit gjithashtu dhe znjsh. Merilin Saraçi e cila merr dhe mandatin e këshilltarit në këtë mbledhje)

## HAPET MBLEDHJA

**Mukades Gixhari** . Atëherë përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj. Gezime Met-hasani, z. Altin Tosku, znj. Fatbardha Sina, z. Sokol Gosa, z. Saimir Cani, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 11-Këshilltarë.

Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për Vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 12.02.2024.

Vendimi nr .5, datë 12.02.2024 “Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit Spille, Njësia Administrative Kryevidh”.

Konfirmohet si kërkesë drejtuar organeve kompetente referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 9/2024.

Vendim nr .6, datë 12.02.2024 “Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për rikonstrukcion të banesave, Bashkia Rrogozhinë”. Konfirmohet si kërkesë drejtuar organeve kompetente referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin Social” i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin 2024”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,  
Prefekt, Afrim Qendro.

Kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 12.02.2024. Jeni dakord me këtë pikë të rendit të ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*



**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, Miratim i pranimit të dorëheqjes nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak të z. Ferdi Avdiu.

Atëherë sipas kërkesës për dorëheqje nga mandati i këshilltarit të z. Ferdi Avdiu, mbështetur dhe në raportin e komisionit të mandateve. E hedhim në votim pranimin e dorëheqjes nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak të z. Ferdi Avdiu. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .7.** Miratohet me 11-vota pro referuar dhe procesverbalit të Komisionit të Mandateve, pranimi i dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z. Ferdi Avdiu.

**Mukades Gixhari** . Pikën 4, “Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Merilin Saraçi” do ta shtyjme për pak më vonë pasi dhe kandidatja është rrugës duke ardhur. Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton përgjegjësi i zyrës së Shërbimit Social z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani** . Përshëndetje të gjithëve! Atëherë në total kemi 20 familje me një fond prej 74 405 (shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë) lekë.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë diskutim për këtë pikë? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .8.** Miratohet me 11-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.749.Prot datë 19.02.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% ”.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 6-të të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton përgjegjësi i zyrës së Shërbimit Social z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani** . Kemi në total 17 familje me një fond prej 69 192 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntë dhjetë e dy) lekë.



**Mukades Gixhari** . Ndonjë diskutim për këtë pikë? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .9.** Miratohet me 11-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me me shkresë Nr.644.Prot datë 13.02.2024,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor“.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 7- të, miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës financiare të familjes së ish këshilltarit të ndjerë z. Bajazit Thaçi”. Relaton drejtori i Financës dhe Shërbimit Social z. Rezart Vogli.

**Rezart Vogli** . Atëherë sipas projektvendimit duke u konsultuar dhe me kryetarin e bashkisë kemi sjellë projektvendimin për ndihmë financiare familjes së të ndjerit z. Bajazit Thaçi në masën 200 000 (dyqindmijë) lekë.

*-Për shkak se audio nuk dëgjohet qartë përmbledhtazi po ju shpjegojmë fjalën e këshilltarëve: Alime Hoxha, Indrit Dedej, Enver Memolla si pjesë e komisionit të financës së këshillit i bëjnë vërejtje drejtorit të financës që në mbledhjen e komisionit të datës 23.02.2024 ju la porosi që kjo ndihmë financiare për familjen e këshilltarit të ndjerë të bëhej në masën total prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh dhe në mbledhjen e këshillit të vinte një projektvendim shtesë që reflektonte kërkesën e komisionit. Propozimi i komisionit të financës u mbështet unanimisht nga të gjithë këshilltarët e pranishëm. Gjendur në këto kushte si dhe duke vërejtur që drejtori nuk e paraqiti dokument për këtë ndryshim. Këshilltarët, Alime Hoxha në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Financës, Indrit Dedej në cilësinë e Kryetarit të grupit të djathtë të këshilltarëve njëkohësisht anëtar i Komisionit të Financës, Enver Memolla në cilësinë e Kryetarit të grupit të majtë të këshilltarëve njëkohësisht anëtar i Komisionit të Financës së bashku me Kryetarene e Këshillit hartojnë projektvendimin “Për një shtesë në projektvendimin, ‘Për dhënien e ndihmës financiare familjes së të ndjerit z. Bajazit Thaçi’ ”, si dhe një Relacionin ku shpjegohet dhe kërkohet nga Këshilli që familja e të ndjerit ish Këshilltarit z. Bajazit Thaçi t’i jepet një ndihmë financiare në total 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, pra 200 000 lekë propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe 300 000 lekë nga Këshilli Bashkiak.*

*-Mbledhjes i bashkohen Këshilltarët znj. Fatmira Thartori, znj. Besnike Coraj dhe znjsh. Merilin Saraçi e cila pret të marri mandatin e këshilltarit, rret minutës së 10 të zhvillimit të mbledhjes.*



**Mukades Gixhari** . Atëherë e hedhim në votim për dhënie ndihme financiare familjes së z. Bajazit Thaçi në total në masën 500 000 (pesëqind) mijë lekë? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 13-vota pro pika 7 (shtatë) e rendit të ditës.*

**Vendim nr.10.** Miratohet me 13-vota pro, projektvendimin i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.775.Prot datë 20.02.2024 “Për dhënien e ndihmës financiare familjes së të ndjerit Bajazit Thaçi“, projektvendimi i propozuar nga Këshilli Bashkiak me Nr.775/1.Prot datë 27.02.2024 “Për një shtesë në projektvendimin, ‘Për dhënien e ndihmës financiare familjes së të ndjerit z. Bajazit Thaçi’ ”, si dhe Relacionin me Nr.775/2.Prot datë 27.02.2024.

**Mukades Gixhari** . Atëherë i kthehem pikës 4, meqë erdhi dhe kandidatja që do marrë mandatin, “Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Merilin Saraçi”. Atëherë pasi jemi njohur me vendimin e KQZ-së për dhënien e mandatit të këshilltarit znj. Merilin Saraçi, mbështetur dhe në propozimin e komisionit të mandateve, kalojmë në procedurën e betimit.

*-Kryetarja ngrihet në këmbë bashkë me kandidaten znj. Merilin Saraçi dhe lexohet formula e Betimit.*

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Rrogozhinë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre.

Betohem.

**Merilin Saraçi** . Betohem.

**Mukades Gixhari** . E hedhim në votim dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Merilin Saraçi? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 13-vota pro dhënia e mandatit të anëtarit të këshillit Bashkiak Rrogozhinë znj. Merilin Artur Saraçi.*

**Vendim nr.11.** Miratohet me 13-vota pro, dhënia e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Merilin Saraçi. Mbështetur në procesverbalin e komisionit të mandateve dhe në shkresën e



ardhur nga KQZ me Nr.444. Prot datë 14.02.2024 “Njoftim për vazhdimin procedurave për dhënien e mandatit”.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 8-të të rendit të ditës, Miratim i projekt-vendimit, “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Rrogozhinë”. Tani kjo ka qenë detyrë e caktuar këshilltarit z. Sokol Gosa, për t’i komunikuar dhe marrë aprovimin kandidatëve të mundshëm për të qenë anëtarë të këtij komisioni. Fjala për ju z. Sokol Gosa.

**Sokol Gosa** . Atëherë fatkeqësisht kemi marrë vesh që kandidati që do propozonim për këtë komision z. Bashkim Kushi ka ndërruar jetë. I shprehim ngushëllime familjes dhe kërkoj që këtë pikë ta shtyjmë për mbledhjen tjetër.

**Mukades Gixhari** . Në rregull pika 8-të e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Kalojmë në pikën 9-të, Diskutim dhe njohje me Projekt Studimin, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullësor, tokat bujqësore dhe inproduktive (PF) në pronësi apo përdorim të Bashkisë Rrogozhinë”. Fjala për përgjegjësin e sektorit të pyjeve z. Artur Kaja.

**Artur Kaja** . Përshëndetje të gjithëve!Grupi i punës i ngritur sipas Urdhërit të Brendshëm nr.41, datë 24.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë hartoi një program pune për verifikimin e tokave bujqësore, inproduktive sipërfaqe pyjore dhe kullësore për t’u dhënë në përdorim me kontratë qiraje.

Tokat bujqësore që do të verifikohen për t’u dhënë me qira për t’u mbjellë me kultura bujqësore, pemtore, ullishte etj, janë kryesisht toka të refuzuara në pronësi apo përdorim të Bashkisë Rrogozhinë. Sipërfaqet e këtyre tokave kanë që nga vitet 1990 e në vazhdim që janë të mbuluara me ferra dhe shkurre të ndryshme që nga viti në vit po vijnë drejt degradimit. Dhënia e këtyre tokave në përdorim do bëhet në zbatim të ligjit nr.8312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” Udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” pika 2, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Sipërfaqe pyjore dhe kullësore që do të verifikohen për t’u dhënë me qira përcaktohen në varësi të qëllimit për të cilën do jepen në përdorim/qira.

Kështu sipërfaqet pyjore që ndodhen në zonën turistike (Spille) apo dhe në zona pyjore të cilat grupi i punës mendon se paraqesin interes për t’u dhënë me kontratë qiraje do të propozohen për t’u dhënë me qira “Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike (kënde lojërash, shëndetësore, shoqërore mjedise sportive, shlodhëse, kulturore etj).

Kjo për faktin se këto sipërfaqe plotësojnë kushtet e nevojshme për t’u dhënë me kontratë qiraje për zhvillimin e turizmit.



Sipërfaqet pyjore apo toka me bimësi pyjore që ndodhen në zona pyjore kodrinore të cilat grupi punës mendon se paraqesin interes për t'u dhënë me kontratë qiraje do të propozohen për t'u dhënë me qira për vendosjen e antenave të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, radiokomunikimit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike.

Sipërfaqet pyjore me shkurre të degraduara, toka me bimësi pyjore dhe kullota të cilat grupi punës mendon se paraqesin interes për t'u dhënë me kontratë qiraje do të propozohen për t'u dhënë me qira për Agropylltari.

Dhënia në përdorim e kategorive të tokave bujqësore dhe pyjore me kontratë qiraje do të ndikonte në :

-Përmirësimin e strukturës së tokës nëpërmjet kryerjes së punimeve, pastrimit të saj nga shkurret dhe ferrat e ndryshme etj.

-Grumbullimin e sa më shumë të ardhurave nga dhënia me qira e këtyre pasurive nga ana e Bashkisë Rrogozhinë.

-Rritjen e mirëqënies së banorëve të këtyre zonave nëpërmjet shtimit të të ardhurave që do të përfitohen nga shitja e prodhimeve bujqësore, blegtorale dhe nga mbjellja e këtyre tokave.

-Do të ndikojë në punësimin e vetë banorëve të këtyre zonave.

-Do të ndikojë në uljen e papunësisë.

-Do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës së këtij objekti duke e bërë atë të frekuentueshëm nga turistë vendas dhe të huaj.

Me anë të këtij studimi do të bëhet e mundur që sipërfaqet e sipërmendura t'i jepen në përdorim personave fizikë, juridikë apo subjekteve të ndryshëm bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

-Ky projektstudim është përgatitur nga grupi i punës sipas një program pune të miratuar dhe në zbatim të Urdhërit të brendshëm nr.41.

-Pas miratimit në parim nga ana e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë, Bashkia Rrogozhinë në bazë të kërkesave të paraqitura, bazuar në aktet ligjore e nënligjore të dala për këtë qëllim do të ndjekë procedurat ligjore për dhënie me qira të këtyre sipërfaqeve pyjore/bujqësore.

-Dhënia në përdorim do të bëhet nëpërmjet procedurave të shpalljes publike që do të publikohet nga Agjensia e Prokurimit Publik dhe me fituesin do të lidhet kontrata përkatëse.

Më poshtë po japim për secilën kategori të fondit bujqësor, pyjor/kullor, vendodhjen, pozicionin gjeografik, llojin e aktivitetit që propozohet të kryhe, bazën ligjore që do të përdoret për dhënie me qira të këtyre sipërfaqeve. Ju faleminderit.

**Indrit Dedej** . Kush është fond pyjor dhe a disponon harta?

**Artur Kaja** . Atëherë fondi pyjor përfshin tokat pyjore, pyjet, shkurret kullotat dhe sipërfaqet inproduktive .





**Indrit Dedej** . Statusin si e ka pyjor apo shkurre?

**Artur Kaja** . Nuk ka... fondi pyjor është një term i gjërë që përfshin thashë tokat pyjore, pyjet, shkurret...

**Indrit Dedej** . I ke të ndara produktive, të frutshme të pafirutshme?

**Artur Kaja** . Po i kam.

**Indrit Dedej** . Nuk mund të jesh i besueshëm pa na sjell ne informacion ...

**Artur Kaja** . Atëherë zotëri t'i më kërkoi kadastrën pyjore...

**Indrit Dedej** . E sjell ti kadastrën jo unë.

**Artur Kaja** . Atëherë fondi pyjor i Bashkisë Rrogozhinë përbëhet nga 2761 ha nga të cilët 1865 ha janë pyje 785 ha janë kullota , kemi dhe tokat me bujqësi pyjore.

**Indrit Dedej** . Për rrugët që i ka zënë ferra kur shkon tjetri në shtëpi çfarë masash keni marrë.

**Artur Kaja** . Ai në qoftë se ka shtëpinë në pyll unë nuk e di... nuk i mbulon pyjorja rrugët.

**Indrit Dedej** . Edhe tokat i ka mbuluar ferra, ke mbjellë ndonjë pemë ti, apo aty ku ka rrëshkitur toka për të mbrojtur tokën.

**Artur Kaja** . Unë kam për detyrë me hartuar projekte, si inxhinier pyjesh hartoj projekte dhe ato miratohen pastaj zbatimi varet nga mundësia që ka Bashkia sa është gjendje, sa lekë ka. Unë çdo vit hartoj projekte për hapje koridoresh për zjarret, mbjellje të reja dhe pastrime të ndryshme. Pastaj ajo nuk varet nga unë realizimi i tyre.

**Indrit Dedej** . Ti ke ardhur me letrat këtu...

**Artur Kaja** . Ky është projekt studim nuk ka të bëjë as me pastrim rrugësh...

**Indrit Dedej** . Ka mungesë dokumentacioni që tek hartat e rrugës hipotekës që nga miratimi i qarkut ta dimë kush janë toka të lira, ta dimë dhe ne.



**Artur Kaja** . Po flasim është projekt studim pastaj pas hapit tjetër do kalojë çdo kërkesë do jetë me hartë.

**Indrit Dedej** . Tek tokat që ke dhënë me qera çfarë fitimesh ke vjelur? Sa kohë ke që nuk mbledh taksat e tokave që janë dhënë me qira?

**Artur Kaja** . Unë i mbledh çdo vit.

**Indrit Dedej** . Unë e di që ti ke një vit që nuk mbledh taksa.

**Artur Kaja** . Kush nuk mbledh taksa?

**Indrit Dedej** . Këtë informacion kam, ta verifikojmë.

**Artur Kaja** . Atëherë mos e ngatërro bujqësinë me pyjet.

**Indrit Dedej** . Pyjet për bashkinë më përpara.

**Artur Kaja** . Bashkia më përpara nuk ka dhënë pyje fare sepse Bashkia ka filluar në 2016 me pyjet atë herë kanë kaluar në bashki. Kontratat e para që janë lidhur për pyjet janë në vitin 2013 në zonën e Spillesë.

**Indrit Dedej** . Edhe në zonën tonë janë dhënë në 2013, në Rrogozhinë para se të bashkoheshim më njësitë.

**Artur Kaja** . Edhe njëherë mos i ngatërroj pyjet me bujqësinë është e vërtetë ajo që thua ti në 2013 janë dhënë toka bujqësore me qira nga ish Bashkia më përpara, jo pyje.

**Indrit Dedej** . Janë dhënë tek Kalemte janë dhënë në Sinaballaj janë dhënë pyje.

**Artur Kaja** . Edhe njëherë pyjet në 2016 kanë ardhur në Bashki të Rrogozhinës, deri në 2016 i kemi pasur ne si Drejtori e Shërbimit Pyjor në Kavajë ka qenë shtet. Në 2016 ka kaluar me vendimin 433 i kanë kaluar Bashkisë Rrogozhinë në pronësi në vitin 2016. Ato kontrata që ju diskutoni të 2013 unë jam në dijeni se i kam hasur këtu kur kaardhur KLSH-ja, janë toka bujqësore që janë dhënë nga ish stafi i parë i 2013 në kundërshtim pa plotësuar kriteret që ne diskutujmë. Ato kriteret që ne po kalojmë njëri pas tjetrit ato nuk janë bërë.



**Indrit Dedej** . E thua ti, me dokumentat që ke sjellë unë nuk jam i bindur...

**Artur Kaja** . Çfarë argumenti kërkon?

**Indrit Dedej** . Nuk shoh as harta, as ndonjë kërkesë nga hipoteka çfarë tokash ka.

**Artur Kaja** . Unë nuk e di nuk ka punë hipoteka tani pyjet dhe bujqësia i kanë kaluar Bashkisë. Pyjet i kanë kaluar në përdorim në 2016 kurse bujqësia sipas njësive administrative ka kaluar që në 2011 në 2010 sipas ish komunave atëherë ka kaluar në përdorim ose në pronësi dhe tani tek këto vendime që është kaluar në 2011 ose 2010 janë marrë tokat që ne kemi diskutuar...

**Indrit Dedej** . Për këto ndërtesat e bashkisë që janë pa letra ke bërë ndonjë kërkesë për letra.

**Artur Kaja** . Unë nuk jam kryetari i bashkisë që të jap ty përgjigje për ndërtesat se nuk kam.

**Indrit Dedej** . Rakordo me kryetarin e bashkisë.

**Artur Kaja** . Nuk është objekt i dhënies me qira ndërtesa apo ferrat që ju përmendët. Ky është një projekt për njohje, që për 2024 janë parashikuar këto se sa do jepen do varet nga kërkesa që do bëjnë qytetarët.

**Silvana Aliu** . Një vendim që morëm ne Prefekti e ktheu mbrapsh duke na thënë që do të shpronësohet me ligj. Tani na jepni hartat për këto toka të paktën për Rrogozhinë, ku ndodhen këto ta dimë ne para se t'i japim se ti ke dhënë këtu toka por ne nuk e dimë se ku janë ku është vendodhja.

**Artur Kaja** . Atëherë këtu janë 100 parcela, ne duhet të bëjmë 100 harta që tua japim.

**Silvana Aliu** . Unë po flas për parcelat e qytetit tim.

**Artur Kaja** . Do ngrihet një Këshilltar tjetër do kërkojë për njësinë e vet. Atëherë kur të ketë kërkesa unë do paraqes hartën si e paraqitëm herën tjetër në këshill.

**Silvana Aliu** . Të rrezikojmë ne...

**Artur Kaja** . Nuk ka rrezikim sepse zonjë aty do bëhet harta sepse do regjistrohet tek zyra e regjistrimit.



**Silvana Aliu** . Do ta kthejë prefekti sërish siç e ktheu.

**Artur Kaja** . Prefekti për çfarë e ktheu e di unë arsyen pse e ktheu edhe unë e diskutova arsyen sepse gjithë Bashkitë tjera si puna e Rrogozhinës japin në përdorim pasi u bibd drejtoresha juridike tha që ke...

**Alime Hoxha** . A mund të na sqarosh dhe ne pse e ka kthyer Prefekti?

**Artur Kaja** . Para tre muajsh ka ardhur një shkresë e ministrisë së drejtësisë që thotë një fond prej kaq hektarësh sipas VKM-së 770 dhe 1077 që janë një për pyjet një për tokat bujqësore me sipërfaqe x , për bujqësinë është 23 mijë e ca hektarë për pyjet 77 mijë e ca hektarë t'i vihen në dispozicion ish pronarëve për shprënësim edhe ka thënë këto ndodhen në Bashkinë x, y etj, ne nuk jemi përmendur fare.

**Alime Hoxha** . Ju nuk ishit në dijeni të këtij vendimi që kishte dalë?

**Artur Kaja** . Jam në dijeni por kur Bashkia jonë nuk është përfshirë për kompensim, për çfarë do jem në dijeni unë?

**Enver Memolla** . Po VKM-ja e vitit 2022, në bazë të VKM-së së 2022 u kthye projektvendimi 0.5 ha.

**Artur Kaja** . Se kuptoj pyetjen.

**Enver Memolla** . A të kërkoi zonja pse u kthye nga Prefektura dhe ishte për një arsye që ju e dinit dhe kur u kthye projektvendimi nuk ishit i pranishëm.

**Artur Kaja** . Kush nuk ishte i pranishëm?

**Enver Memolla** . Ju.

**Alime Hoxha** . Duhet të kishit ardhur .

**Enver Memolla** . Dhe sekretari ka lexuar dhe ka thënë ky amendament ka dalë në 2022-in apo jo?

**Artur Kaja** . Unë nuk isha i pranishëm sepse nuk pata njoftim që duhet të vija.



**Enver Memolla** . Kur je i pranishëm dhe sjell projektvendimin për ta kaluar, duhet të jesh dhe i pranishëm për të marrë përgjigjen tonë përgjigjen tënde në këtë rast pse është i paligjshëm ose sektori juridik sepse unë nuk do rri tani të “shti fall” është i ligjshëm është i paligjshëm.

**Artur Kaja** . Nuk është i paligjshëm. Tani unë nuk kapem tek puna e secilit se sa e ka kapacitetin secili nga ato që e kthen vendimin.

**Enver Memolla** . Unë nuk jam tek kapaciteti i tyre unë jam në tavolinë nuk jam atje lart.

**Artur Kaja** . Unë kam shkuar në zyrën juridike në prefekturë e sqarova edhe bashkë me vendimet përkatëse ku është e përfshirë bashkia Rrogozhinë tek tokat bujqësore për t’u dhënë me qira? Ma gjej sepse të gjithë bashkitë tjera janë të përfshira një pjesë jugu. Është Rrogozhina? Jo , po kam frikë unë? - Si paske frikë ti?!

**Enver Memolla** . Atëherë po del aty ku thashë unë pse nuk erdhe në këshill bashkiak ta prezantoje?

**Indrit Dedej** . Ti z. drejtor na premtove një premtim solemn, the që në qoftë se unë jam gabim jap dorëheqjen... Prefekti nuk ta kaloi...

**Artur Kaja** . Nuk jam gabim fare.

**Alime Hoxha** . Ai tha në qoftë se është e mbjellë unë do jap dorëheqjen dhe ajo e mbjellë ishte.

**Artur Kaja** . Kush është e mbjellë? Është e mbjellë?

**Enver Memolla** . 0.5 ha.

**Artur Kaja** . Me çfarë është e mbjellë?

**Altin Tosku** . Është punuar para se të jepet.

**Artur Kaja** . Aty përveçse një sheshi...

**Altin Tosku** . Unë them është punuar nuk duhet të preket e fundit fare.

**Artur Kaja** . Aty përveçse një sheshi që është bërë pusi nuk ka asnjë gjë tjetër.



**Enver Memolla .** Me lejen e kujt është bërë pusi?

**Artur Kaja .** Atë ta kontrollojë policia kush merret...

**Enver Memolla .** A jeni ju drejtorja përkatëse që bëni denoncimin tek policia bashkiake?

**Artur Kaja .** Si?

**Enver Memolla .** A jeni ju drejtorja përkatëse e pyjeve që duhet të bëni denoncim për zbatim toke?

**Artur Kaja .** Jo nuk e ka zaptuar ai... ai ka bërë një pus.

**Enver Memolla .** Ka prishur gjelbërimin, ka prishur shkurret dhe ka bërë një pus.

**Artur Kaja .** Jo aty ka qenë fushë ka qenë pa shkurre pse po e japim me qera. Jo gjithë sipërfaqja është e zënë tani nuk e di.

**Indrit Dedej .** Atëherë unë nuk e di por dua që kolegët mos rrëshkasin në këtë lloj prizmi se nuk jemi dhe profesionistë.

Artur Kaja . Mua më vjen keq ju mos u kapni as tek ferrat me pastruar ferrat as tek ndërtesa sepse nuk bëj ndërtesa.

**Lulzim Hasa .** Në mandatin e këshillit të kaluar u dha në përdorim pylli i Bedenit, u tha që do investohet dhe do kthehet në një zonë atraktive për pushuesit dhe do punësoheshin shumë njerëz nga ajo zonë. Ka kaluar 4 vite dhe investime nuk janë bërë dhe jo që të punësojë të tjerë por dhe ai që punonte në emër të bashkisë e ka hequr nga puna. Sa vite ka pa paguar qeranë e tokës?

**Artur Kaja .** Vetëm një vit.

**Lulzim Hasa .** Premtimin që ka bërë 4 vite dhe në këshillin e atëhershëm na është thënë që ky do investojë ...

**Artur Kaja .** Luli më fal, kontrata është lidhur me 21 Dhjetor 2021 për korrektesë, kur të vijë Dhjetori i 2024 i mbush...



**Lulzim Hasa** . Artur pse e hoqe nga puna atë që kishte punësuar Bashkia, në çdo kontratë që lidhet në çdo vend ai që është i punësuar rri në punë. Një premtim që është dhënë para këshillit dhe në kontratë këtu e ke taksative dhe çdo objekt që privatizohet njeriu i punësuar rri po aty, ai e hoqi e mbajti 8-muaj në punë me gënjeshtër dhe nuk i dha asnjë qindarkë. Është kështu Artur?

**Artur Kaja** . Ju po kërkon diçka që nuk është në dorën time, nuk është në dorën time heqja...

**Enver Memolla** . A ke qenë relatori ti?!

**Lulzim Hasa** . Ai duhet të vijë të japë informacion këtu.

**Indrit Dedej** . Nuk jemi në gjendje me 3 fukarenj që i ka kapur tërmeti nuk jeni në gjendje t'i gjeni një copë tokë që të bëjë shtëpi nga Çekët nuk jeni në gjendje Bashkia që t'i gjeni një tokë Bashkia.

**Artur Kaja** . Mua më vjen keq që ky debat gjeneron në këtë formë pyetje, diku me pastrim ferrash diku me ndërtesat, diku me rojet thashë dhe njëherë roja në moment që lidh kontratën subjekti është i detyruar të vendosi roje private edhe ai e ka vendosur rojen tani ...

**Indrit Dedej** . Çfarë interesash ka Bashkia, çfarë përfitimesh kemi ne?

**Artur Kaja** . Se po merr lekët të ardhurat nga Bashkia, ke marrë 24 milion nga Bedeni.

**Indrit Dedej** . Sa kohë ka pa paguar?

**Artur Kaja** . Një vit.

**Indrit Dedej** . Pse nuk i merr?

**Artur Kaja** . Ja kemi çuar njoftimet dhe në qoftë se nuk ashtu i prishim kontratën. Nuk lidhje Bedeni me prokurorinë mos kalojmë në gjëra të përgjithshme.

**Mukades Gixhari** . Ta dëgjojmë pak z. Enver Memolla.

**Enver Memolla** . Faleminderit kryetare, tani kërkoj ndjesë kolegëve se ndoshta mund të zgjatëm pak, por realisht duhet me u zgjatur, marr shkas dhe nga debatet. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë për bashkinë. A jeni ju organi kompetent për të bërë planin projektstudimin e zonës?



**Artur Kaja** . Po, projektstudimin po.

**Enver Memolla** . Ju jeni organi kompetent. Pse e sillni në këshill bashkiak?

**Artur Kaja** . Sepse ligji për pyjet dhe për bujqësinë thotë kështu, po citoj përpara ligjin për bujqësinë : Strukturat përgjegjëse të bujqësisë çdo fillim viti, studiojnë sipërfaqet bujqësore që do të jepen për vitin 2024 që jemi në konkretisht apo vitin tjetër 2025. Tjetra pyjet çdo fillim viti hartojnë dhe miratojnë projektin për dhënien me qera të pyjeve pastaj ky projektstudim do zërthehet pjesë pjesë në qoftë se do ketë kërkesa për të marrë me qera sepse mund të ketë në gjithë vitin nuk vjen asnjë.

**Enver Memolla** . Mos i bjer nga Kina. Pse e sjell në Këshill Bashkiak?

**Artur Kaja** . Sepse duhet të kalojë.

**Enver Memolla** . Jo, sepse Këshilli Bashkiak është promar i pronave të Bashkisë Rrogozhinë.

**Artur Kaja** . Më fal dhe ky është një projektstudim jo projektvendim është për njohje nuk është për miratim.

**Enver Memolla** . Tek kompetenca po dal, nëse do ishte kompetencë e plotë e Bashkisë Rrogozhinë ky nuk vjen në Këshill Bashkiak.

**Artur Kaja** . Është për njohje.

**Enver Memolla** . Mos më ndërpre të lutem. Dhe e dyta ky projektstudim është i cunuar këtu nuk është as 20% e punës, pse do ta them më pas por ta kesh të qartë këtë pjesë. Nëse ti bën një projekt total të Bashkisë Rrogozhinë me këtë material nuk e di por qofshi ju. Pyetja tjetër është afati kohor i ngritjes së Komisionit nga Kryetari i Bashkisë 24 Janar me 20 Shkurt vjen në komisionin e ekonomisë. A është afat i mjaftueshëm 20 ditë pune për krehjen e të gjithë zonës për të bërë këtë studim?

**Artur Kaja** . Ky projektstudim ka qenë edhe vjet, po ky projektstudim është hequr Bedeni nesër po ky projektstudim do jetë do hiqen ato sipërfaqe që do jepen këtë vit dhe nuk ka nevojë me i studiuar sepse toka nuk ndryshon toka është po ajo tokë.

**Enver Memolla** . Atëherë ti po thua që në 24.01.2024 është ngritur komisioni dhe po thua që





komisioni nuk ka shkuar fare në terren, kemi marrë çfarë kemi pasur vjet kemi hequr Bedenin që është dhënë me qera dhe është po ky projektstudim.

**Artur Kaja .** Kush tha që nuk kemi shkuar në terren?

**Enver Memolla .** Sapo e the ti, kemi hequr Bedenin është po i vjetshmi.

**Artur Kaja .** Po.

**Enver Memolla .** Unë fjalët tua po përsëris.

**Artur Kaja .** Unë verifikoj ato që heq atoqë janë dhënë me qera i heq ato tjerat janë po ato sipërfaqe. Po këtë sipërfaqe që unë kam raportuar vjet është ajo nuk ndryshoi.

**Enver Memolla .** Do dal tek sipërfaqja se i kam këtu të printuara. Keni ju evidenca totale flas të paktën për qytetin e Rrogozhinës malësinë e Rrogozhinës për tokat se sa është prona e zënë në kllapa ose të dala jashtë ligjit në bazë të anulimeve të vitit 2019 kur është bërë afatet 95 vjeçare. A keni një evidencë sa janë në total?

**Artur Kaja .** Çfarë tokash po flet, ndaji tokë bujqësore dhe pyjore.

**Enver Memolla .** Po pra se ke shkruar “Kemi të dhëna se disa pjesë të tyre janë të zëna në mënyrë të paligjshme nga fermerë të ndryshëm...

**Artur Kaja .** Po.

**Enver Memolla .** ... në mënyrë të paligjshme një apo nga anulimi i kontratave të para”?

**Artur Kaja .** Nuk ka pasur kontrata më përpara.

**Enver Memolla .** Unë në dijeninë time di që ka pasur deri para një viti janë mbajtur taksat për këtë pjesë dhe këtë vit personat përkatës kanë shkuar të paguajnë nuk janë marrë taksat për këtë pjesë.

**Artur Kaja .** Arsyeja?

**Enver Memolla .** Arsyen e di Bashkia nuk e di unë po të pyes ty tani.



**Artur Kaja** . Atëherë që tasqaroj këtë pikë , unë faktike kam ardhur në 2017 dhe i di nuk po them më mirë sa ju por edhe të 2013. Arsyeja pse kanë qenë anuluar ato, biles në 2017-2018 ka ardhur KLSH-ja, ka anuluar tokat që janë dhënë me qera nga Bashkia Rrogozhinë, janë paraqitur 27 kontrata të zonës Sinaballaj dhe Rrogozhinë fshat dhe KLSH i ka kontrolluar kontratat një për një i ka parë që nuk është ndjekur kjo rruga ligjore e konfirmimit kalimit në këshill etj.

**Enver Memolla** . Nuk po të kërkoj atë pjesë që thua ti për pjesën e anulimit unë po të them në malësinë e Rrogozhinës ke shkryar këtu 1,2,3,4,5,6 parcela dhe poshtë ke thënë kemi të dhëna që disa pjesë të tyre janë të paligjshme. Unë po të bëj një pyetje të thjeshtë tek parcela 1/4 duhet ta di sa pjesë është në 1 ha që këtu është zënë? Sepse tek parcela 278/1 ti ke 1.75 ha. Sa është totali i parcelës së gjithë?

**Artur Kaja** . Unë kam thënë 1.75 është e zënë.

**Enver Memolla** . 1.75 sipërfaqe është e zënë?

**Artur Kaja** . Po.

**Enver Memolla** . Sa kërkon ti?

**Artur Kaja** . Gjithë do jepet me qera.

**Enver Memolla** . Gjithë po kush është 1.75 e zënë këtu dhe kush del e paligjshme?

**Artur Kaja** . Ai që është aty nesër pasnesër do paraqisi kërkesën për të ja dhënë me qera.

**Enver Memolla** . Jo pa qëllim ta kam printuar sepse është kontrata që është anuluar pas 2019 dhe është kontrata që blloki për rreth dy vite servitutit e kalimit në atë zonë. E di ku bëhet fjalë? Sepse po më thua shkurre por kjo është ullahtë e ndarë me 7501.

**Artur Kaja** . Është tokë bujqësore?

**Enver Memolla** . Zotëri është e ndarë me 7501 është ullahtë. Këtu ka servitut?

**Artur Kaja** . A e bëmë servitutit e asaj parcele, që ishte propozimi juaj?



**Enver Memolla** . Po pra por kjo parcela këtu e bllokoi një vit e gjysëm.

**Artur Kaja** . Tani unë nuk do përgjigjem për 2013.

**Enver Memolla** . Jo ti përgjigju për planin, ke sjellë një plan këtu dhe thua shkurre kur ktu ka ullinj dhe kjo toka këtu është komplet e shtetit.

**Artur Kaja** . 1/78 është zënë me shkurre?

**Enver Memolla** . Po ti e ke shkruar në fillim “ferra dhe shkurre të ndryshme” e ke në nisje.

**Artur Kaja** . Shiko parcelën mos u nis tek shkrimi, unë kam shkruajtur që këto parcela që mendojmë ne ti japim me qera janë me shkurre i kanë zënë ferrat se kanë vite që nuk punohen.

**Enver Memolla** . Atëherë ti po thua që 1.75 ha këtu është e zënë me ullishtë? Ta kthej pjesën tjetër?

**Artur Kaja** . Një pjesë është dhënë një pjesë do jepet në qoftë se nuk është dhënë.

**Enver Memolla** . Këtu cedon ti, se 1.75 mund të jetë ajo me 7501 që janë me AMTP “Ullishtet”. Sa është sipërfaqja e zënë, që ti e do të lirë? Sepse këtu është gjithë ullinj, kujt do të ja japësh nesër?

**Artur Kaja** . Ai që ka ullinjtë.

**Enver Memolla** . Ai që ka ullinjtë do ta marri?! -Po qenka përcaktuar.

**Artur Kaja** . Unë nuk e di ju për qytetarët bëheni objekt pengimi për mos ... edhe Bashkia nuk merr asnjë lek edhe qytetari ... Ato qytetarë që i kanë zënë nuk janë as kushërinjë e mi, se unë jam nga Kryevidhi nuk kam asnjë nuk dua me mbrojtur asnjëri por mbroj të drejtat ... Edhe detyra e KLSH-së që ishte tani, ka thënë kështu edhe sipërfaqet që janë pezulluar nga 2013 s’duhet prishur kontrata por duhen rinovuar të plotësohet dokumentacioni dhe të jepen me qera. Edhe kjo bëhet një studim nga Kryeluzaj deri në Sinaballaj, të gjithë fermerët që kanë zënë ullinj mbi 1 ha që plotësojnë kushtet të jepen me qera. Se bëjmë ne?! Nuk është faji i asnjërit.

**Enver Memolla** . Po del tek evidenca që u kërkua, a ke ndonjë evidencë të këtyre të anuluarve?



E keni evidencën të ullishteve, pemëtoreve, frutave apo çfarë janë mbjellë që janë anuluar kontrata pa marrë parasysh? Sepse tokat janë të mbjella.

**Artur Kaja .** Kontratat e para që janë prishur, janë të evidentuara se secili ka atë sipërfaqen e vet, kurse pjesa tjetër...

**Enver Memolla .** Ndaj po të them që informacionin e ke të cunguar sepse kjo parcela këtu. Sa hektarë është e gjitha?

**Artur Kaja .** Ti e ke nxjerrë nga ASIG.

**Enver Memolla .** Unë e kam nxjerrë nga ASIG doja hartë 1;5000 por se kam këtu.

**Artur Kaja .** Ta jep ASIG atë parcelë se sa hektarë është, ti paske hyrë deri aty.

**Enver Memolla .** Kam hyrë sepse nuk vi kot këtu.

**Artur Kaja .** ASIG ta jep se sa hektarë është ajo parcelë prandaj.

**Enver Memolla .** Dhe po ta them se detyrohem të hy tek ASIG të marr unë parcelat e Rrogozhinës, duhet të mi sjellësh mbrapa...

**Artur Kaja .** Nuk ka nevojë...

**Enver Memolla .** Si nuk ka nevojë projektstudimi , ku ta di unë ku zonë është ullishta atje, apo ku është toka? Ma trego mua ku është 627/1 si parcelë? Se unë nuk e di ku është. Ku është tani në hartën e Rrogozhinës nga “Bishti i Zhurit” në kufi me Sinaballajan në kufi me Memollaj, Okshunin ku është nuk e di ku është kjo tokë? Prandaj më duhet harta ta shoh dhe unë ku është, sepse mësojmë si puna e asaj pullës së zezë tek toka lart.

**Altin Tosku .** Nuk duhet të vijë gjithë Rrogozhina në një ditë , duhet të vijë zina e Rrogozhinës të merremi me kodrat e Rrogozhinës, zona e Sinaballajt me fshatrat në një ditë tjetër nuk duhet të vijë e mbledhur e gjithë dhe duhet ta sjellësh hartën për çdo projekt.

**Enver Memolla .** Është 15 ha tokë gjithë parcela, por nuk po shoh shkurre se ka vetëm ullinj.

**Artur Kaja .** Ajo ullishtë që është ajo do jepet me qera.



**Enver Memolla** . Po mirë po kujt do të ja japësh.

**Artur Kaja** . Ajo pjesë që është zënë nga fermeri do i jepet fermerit që e ka zënë sepse ai që është mbjellë me ullinj 20 vjeçar do ja marrim fshatarit ne të ja japim një tjetri.

**Silvana Aliu** . A e ke pasur një kontratë?

**Artur Kaja** . Nuk ka pasur kontratë qytetari, ato që kanë qenë kanë qenë në Sinaballaj, në 2017 KLSH-ja i konsideroi të pavlefshme unë i kam nisur të gjithëve njoftimet pavarësisht se nuk ishte detyra ime që të gjithë personave që ju prish kontrata i thashë: - “Zotëri kontrata juaj është prishur sepse nuk është në bazë të ligjit”. Ato kanë ardhur pastaj secili me kokën e vet më pas kanë shkuar tek banka ose tek arka e Bashkisë dhe kanë paguar lekët. Unë nuk ruaj secilin që paguan.

**Altin Tosku** . Po Bashkia pse duhet t’i mbajë këto taksa?

**Artur Kaja** . Po ai që i ka mbajtur ai po përgjigjet dhe penalisht.

**Altin Tosku** . Nuk e di unë, duhet ta dijë Bashkia.

**Artur Kaja** . Pse i ka mbajtur lekët kur KLSH i ka prishur kontratën.

**Enver Memolla** . Artur kam një pyetje tjetër më shumë llogjike. Po marr parcelën 278 ku jam i përfshirë dhe vetë në këtë pjesë ku e di se çfarë është kam vuajtur vetë dy vite për servitutin. Dua të di kjo parcelë me kë numër pasurie kufizohet? Kjo parcelë a ka rrugë aktuale?

**Artur Kaja** . Ty të duhen kufizimet...?

**Enver Memolla** . Në një studim hyjnë të gjitha këto, sepse për të shkuar tek parcela 278 unë ndoshta shkoj tek 271 t’i prish rrugën t’i prish ullishtën ku ta di unë tani se çfarë ndodh.

**Artur Kaja** . Mua më vjen çudi, çdo parcelë kur të jepet me qera do përgatitet plani i rilevimit në moment që ajo do kërkohet nga qytetari edhe ai qytetari kjo sipërfaqe do jepet me qera brenda 278 mund të marrin 10 vetë me qera.

**Enver Memolla** . Plani i rilevimit paraqitet kur vjen kontrata me planin e biznesit në Bashkinë Rrogozhinë kur t’i bësh kontratën.



**Artur Kaja** . Plani i rilevimit është ai zotëri që ne diskutuam mbledhjen e fundit.

**Enver Memolla** . Unë dua hartën kadastrale 1;5000 për malësinë e Rrogozhinës qoftë me frut, qoftë pa frut, qoftë ulla qoftë që ta shoh projektstudimin e saktë sepse unë po nuk e pashë do zihem me Indritin nesër.

**Artur Kaja** . Ky është një projektstudim edhe nuk ka të bëjë ky u studiua tani dhe fillojmë o burra të japim tokat me qera.

**Enver Memolla** . Është projektstudim që është bërë për 22 ditë pune.

**Artur Kaja** . Unë po ta sjell për njohje.

**Enver Memolla** . Nuk merret parasysh fare nuk marr fare parasysh as për njohje, një projektstudim për 22 ditë për gjithë Rrogozhinën. Po të ishte për një njësi po e marr sepse është i paplotë, çdo pronë nuk ka kufitarët nuk e di kush e ka, kjo tokë nesër do jepet parcelë do vijë prap harta zezë këtu.

**Artur Kaja** . Ver ju mund të kërkoni çfarë të doni, këtë projektstudim të paktën 7 vjet kam që e kaloj këtu në Këshillin e Rrogozhinës në mbledhje është hera e parë që unë i dëgjoj këto gjëra jo ferra, jo ndërtesa .

**Enver Memolla** . Nuk po them ferra po them më sill hartën 1;5000, sepse një studim zone duhet të ishte dhe me poëer point aty se nuk njo zonën ku është shoku im unë nuk njoh hartën ku është 1/4 unë njoh Rrogozhinën që kufizohet me lumin Shkumbin, kufizohet me fshatrat e malësisë.

**Artur Kaja** . Kur të jepet me qera ajo 278 njërit apo 5 persona sa të jenë aty, atëherë duhet t'i kërkosh këto gjëra.

**Enver Memolla** . Dhe atëherë kur këshilli të mos e kalojë , se kaloi Këshilli diskutohet.

**Artur Kaja** . Si?

**Enver Memolla** . Jo, përrallë nga e kaluara nuk e kaloi këshilli se nuk duan ... kështu keni thënë.

**Indrit Dedej** . E ktheu Prefekti asnjë nuk mba përgjegjësi.



**Artur Kaja** . Prefekti të thashë për çfarë nuk e kaloi unë ta shpjegova arsyen.

**Indrit Dedej** . Ti the unë bëj dorëheqje në qoftë se kjo nuk është kështu si them unë.

**Artur Kaja** . Merre kasetën dëgjoje, ka qenë kështu në qoftë se ajo sipërfaqe është punuar kam thënë, jo nëse nuk e kalon Prefekti

**Mukades Gixhari** . Ta dëgjojmë z. Sokol Gosa.

**Sokol Gosa** . Dy fjalë, ky material që na është paraqitur sot mësuam si projekti që erdhi para dy muajsh për një investim dhe na u refuzua nga Prefektura për arsye të mosinformimit nga ana e drejtorisë sepse sipas një vendimi të ministrisë nuk lejoheshin dhe kjo është një e metë shumë e madhe. Edhe sot po ky fenomen unë e kërkova edhe herën tjetër ore sillni hartat dhe më e bukura është se zotëria ka pasur tre parcela Spille se ku janë këto parcela ai i di shumë mirë. Shumë mirë edhe kush do t'i marri dhe kush i ka kërkuar ato parcela për t'i shfrytëzuar, jo për t'i shfrytëzuar në të mirë të komunitetit, të pushuesve, të turizmit por për përfitime personale aty kemi dhe praktika. Doja me e pyetur a kemi pasur praktika më përpara? Ka se janë dhënë dhe aty me drejtorin e pyllit të Spillesë dhe është bërë babëzi, një shfrytëzim pa kriter, ka ndodhur edhe prerja e pishave dhe zotëria tani me këto lloj projektesh ose studimi që do bëjë ngreni ju dorën thotë këshilltar t'i bëj unë qoka tre miqve të mi, shokëve të mi për t'i dhënë. Kurrën e kurrës kjo për sa i përket ... ta mbaroj se na fute në qorrsokak dhe si vjen këtu në vend që të kërkosh falje... të paftë kush ju ka vënë ju me këto pozicione, ik dorëzohu me nder sa të përfundoni keq e më keq. Na fute pra në siklet nuk doja ta hapja këtë temë me zotërinë atje tani po na hap prap punë. Çfarë kujton ti, kukulla jemi ne këtu? Jo, more zotëri jo çdo vendim që do ta marrim do merret me kosto se dhe kundërshtime do ketë por ama duke njohur ligjet pa i shkelur. Thotë Enveri tani për 20 ditë kush jeni ju që bëni për 20 ditë, çfarë janë këto studime kështu për 20 ditë? Duhet muaj dhe vite që të bëhen studimet si për Spillenë apo të pyjeve të zonës tonë, toka të mbjella, shkurre apo çfarë janë se nuk jam i këtij sektori të bujqësisë edhe me disa parcela të tjera. Veri thotë me ulla ti thua janë me shkurre. Hera parë dhe e fundit me kto lloj mos hajde në këshill, unë për vete jo njëherë nuk kaloj kurrën e kurrës këto lloj paçavuresh që ju sillni. Faleminderit, kryetare.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit.

**Sokol Gosa** . E të mos zgjatemi më me këtë temë, kalojmë tek pika tjetër.

**Mukades Gixhari** . Jo nuk është për votim. Pika 10, "Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe



Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Përgjegjësi i sektorit të pyjeve z. Artur Kaja.

**Artur Kaja** . Atëherë në përgjigje të shkresës tuaj nr.403, datë 30.01.2024 në lidhje me masat e marra për sistemin e kullimit dhe të vaditjes si dhe gjendjen e rezervuareve në Bashkinë Rrogozhinë ju bëjmë me dije se :

Mbi punën e bërë në sistemin e kullimit dhe vaditjes në periudhën Janar- Dhjetor viti 2023 nga zyra e bujqësisë për Bashkinë Rrogozhinë është punuar në sistemin dhe riparimin e kanaleve kullues e vaditës si në hapjen e pastrimin e kanaleve të II-III në të gjithë territorin e Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësitë Administrative.

Po kështu kemi riparuar kalimet e kanaleve nga një parcelë në tjetrën dhe nga njëra anë e rrugës në tjetrën me tombina (tuba) të dimensioneve të ndryshëm në përshtatje të kanaleve vaditës.

-Për sa i përket kanaleve vaditës duke marrë shkas dhe nga ankesat e shumta të fermerëve të Rrogozhinës dhe Njësi Administrative dhe dërgimit të shkresave të shumta tona drejt Bordit të Kullimit Durrës dhe Ministrisë së Bujqësisë ju dha zgjidhje problemeve më të mëdha të kanalit Peqin-Kavajë. Ky kanal është shumë i rëndësishëm për ujitjen e tokave bujqësore për njësinë Sinaballaj, Gosë Lekaj po ashtu për fermerët e qytetit të Rrogozhinës.

Është bërë përforcimi me beton i tre pikave më problematike ku një është në zonën e Sinaballaj dhe dy në Rrogozhinë. Për vitin 2024 pastrimi dhe forcimi i lugjeve preitet të përfundojë dhe të jetë gati për sezonin që vjen.

Gjatë 2023 janë pastruar 2.5 km kanal vaditës nga zona pas burgut të Rrogozhinës deri në drejtim të autostradës më numër kadastral 3235.

Është pastruar 200 ml përroi që kalon afër lagjes së “dy çezmave” në drejtim të autostradës.

Është pastruar 1 km kanal vaditës në fshatin Harizaj Njësi Administrative Lekaj.

Është pastruar 1.2 km kanal vaditës me numër kadastral 360 në fshatin Gërmenj.

Është pastruar 1 km kanal vaditës nga rezervuari deri tek lagja e Bicerrve në fshatin Zanbishë.

Për sa i përket kanaleve kullues gjatë vitit 2023 është bërë një punë e konsiderueshme si nga Bashkia Rrogozhinë ashtu dhe nga bashkëpunimi i Bashkisë me bordin e kullimit Durrës.

Është pastruar KK Primar me numër pasurie 600, ZK 3235 Rrogozhinë 1.6 km.

Është pastruar KK Primar me numër pasurie 607, ZK 3235 Rrogozhinë 1.61km.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 593, ZK 3235 Rrogozhinë 300 ml.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 517, ZK 3235 Rrogozhinë 270 ml.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 594, ZK 3235 Rrogozhinë 700 ml.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 595, ZK 3235 Rrogozhinë 850 ml.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 560, 196 Rrogozhinë me një gjatësi 1.8 km i cili shërben për kullimin e tokave bujqësore fermerëve të Rrogozhinës dhe të Sinaballaj. Në këtë kanal kemi rregulluar dhe dy ura me tombina.





Gjatë 2023 është pastruar i gjithë kanali kullues me emrin K5 me gjatësi 20 km ku i vjen në ndihmë fermerëve të fshatit Gosë, Ballaj Vilë.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 326 me gjatësi 800 ml në Gosë.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 627 me gjatësi 1 km në Gosë.

Është pastruar KK Sekondar me numër pasurie 129 me gjatësi 1.2 km Kërçukaj i cili shërben dhe për pastrimin e ujërave të zeza.

Është pastruar KK Sekondar me numër kadastral 127 me gjatësi 870 ml në Spille.

Është pastruar KK Sekondar me numër kadastral 139 me gjatësi 440 ml në Spille.

Është pastruar KK Sekondar me numër kadastral 136 me gjatësi 580 ml në Spille.

**Fatmira Thartori** . Ne i kemi përpara këto ndjesë... Tani i pamë të gjitha këto i lexuam i kemi lexuar edhe në shtëpi se informacinet na kanë ardhur 5 ditë përpara. Kemi akoma kanale pa pastruar ... taman nuk janë pastruar fare në Gosë sidomos nëpër ara janë të gjithë kënetë po kthehet kënetë në Gosë të madhe. Shumë mirë është punuar do punohet kur do pastrohen këto se me datë 1 Maj vjen kanali edhe duam ujë nëpër ara dhe të na vaditen taman tokat, të bëhen taman kullimet, kur do bëhen? Sepse kanë të paktën toka që kam unë të miat kanë 30 vjet që nuk janë kulluar asnjëherë s'është bërë asnjëherë kanali kullues këtë duam ne. Shumë mirë këto janë bërë faleminderit, kur do na bëhen tjerat këtë presim ne?

**Altin Tosku** . Atëherë këtu në diskutim që foli drejtori, këtu duket sikur janë pastruar të gjithë kanalet me kaç sa është... Atëherë këto pastrime që duhet të bëhen, duhet të bëhen me ndarje që dhe na ta dimë ku janë pastruar se ne nuk i dimë mirë me kodet e kanaleve, duhet të vijë me videoprojektor këtu dhe të thotë ky kanal u pastrua kjo vijë kanali ... Këtu qenka pastruar gjithë Rrogozhina. Unë nuk shoh pastrim kanali në Rrogozhinë të zonës të gjitha sa bëhen. Këto me letra janë të gjitha bravo, kur del pastaj për vaditje u bllokua kanali ose do ripastruar se u pastrua para dy muajsh se di nuk e kuptoj.

**Mukades Gixhari** . Z. Enver Memolla.

**Enver Memolla** . Faleminderit Kryetare. Doja vetëm pak informacion sepse nuk jemi njohur me anë të numrave shifrave se ku bëjnë pjesë këto kanale që janë pastruar të paktën për qytetin e Rrogozhinës. Me nr. pasurie 600 - 607 ku ndodhen në cilën zonë të Bashkisë Rrogozhinë, në cilat parcela këtu që janë pastruar? Është pastruar kanali primar me numër pasurie 600, 1.6 km ku ndidhet në cilën zonë të Rrogozhinës?

**Artur Kaja** . Ky është informacion i drejtorisë së bujqësisë dhe unë ...



**Altin Tosku** . Atëherë duhet të ishte drejtori i bujqësisë.

**Artur Kaja** . Drejtori është i sëmurë.

**Altin Tosku** . Duhet të ketë njeri tjetër mbrapa.

**Enver Memolla** . Sa personel është zyra jote?

**Artur Kaja** . Gjashtë.

**Enver Memolla** . Po 4 tjerë ku janë?

**Artur Kaja** . Unë jam inxhinier , njëri është i mbrojtjes së konsumatorit, njëri është veteriner, agronom vetëm një kemi që është drejtori.

**Enver Memolla** . E di që drejtori është në Tiranë. Kam një gjë më shumë e kam për trabsparencë për publikun se pothuajse jemi e vetmja Bashki që çdo mbledhje e bëjmë online. Dhe kur Enveri atje jashtë është duke parë këtu dhe shikon që është pastruar kanal primar me numër 600, ku është? Të lutem informacionin na e sillni më të saktë, që kap parcelën kaq, kap çarjen, kap ish teqen. Tani ti nuk je këtu për këtë pjesë por realisht unë kam një fermer këtu që realisht i vlerësoj se punojnë shumë dy vëllezër por nuk shkon dot në parcelë Turo. Po ta them që ta dëgjojnë dhe drejtori. “Kanali i Zogut” shiko çfarë ka bërë mirë që nuk kalohet se ka aromë të pakëndshme por realisht nuk shkohet as me punuar. Ka mbjellë 12 ha shegë do mbjelli akoma, çfarë do bëjë, ku do mbytet është fermer.

**Indrit Dedej** . Çfarë ndihme i ofron Bashkia atij?

**Enver Memolla** . Mua më vjen zor sinqerisht kur i bie telefonit tim si anëtar këshilli sot nuk di çfarë t’i them më. Këtë pikë shtyje për herën tjetër zysha kur të jetë drejtori prezentë nuk kam çfarë them unë tani.

**Sokol Gosa** . Shtyje që të na japë me fakte me pamje ta dimë... ose po dalim t’i shikojmë vetë, t’i kontrollojmë vetë kështu i bie.

**Enver Memolla** . Është gjynah.

**Mukades Gixhari** . E shtyjme për mbledhjen e radhës të vijë të na relatojë drejtori i bujqësië.



**Silvana Aliu** . Edhe drejtori të vijë të ngrehet komision.

**Fatmira Thartori** . Jam dakord për këtë pikën e komisionit, ne jemi vend bujqësor, çfarë po bëjmë ne për bujkun, çfarë po bëjmë ne për veten tonë?

**Enver Memolla** . *(Këshilltari tregon pamje nga celulari)* Ja është nisur për tek bagja nuk shkon dot të spërkasë ftonjtë.

**Fatmira Thartori** . Të vihen në punë, ka dy vjet ai skrepi rri në mes të arës, çfarë bëhet kështu?

**Indrit Dedej** . Na tregoni një punë që dhe Bashkia po bën një punë edhe ne duartrokasim sot kemi shkuar kemi prerë ferrat filan vend. Sot varrezat i ka mbuluar nëpër fshatra .

**Silvana Aliu** . Sipas drejtorit të bujqësisë i bie që çdo fshatari do t'i mbesë uji tek toka, atij që do i shkojë.

**Mukades Gixhari** . Do thërrasim drejtorin e bujqësisë mbledhjen e radhës.

**Silvana Aliu** . E kam shkruar dhe në grup serioziteti që kanë drejtorat e Bashkisë është minus. A nuk na përfillin, a e konsiderojnë këshillin bashkiak diçka pa vlerë se kuptoj, të vijë drejtori mos japë... është sëmure.

**Fatmira Thartori** . Ishte dje ai çuni nuk themi që nuk ishte por të vihen në lëvizje instancat e tjera që të dalë puna në dritë.

**Artur Kaja** . Ju nuk e kuptoni sa të vështirë e kam unë që Bashkia Rrogozhinë 7 vite që kam unë këtu nuk është mbjellë një pemë.

**Indrit Dedej** . Nuk është mbjellë.

**Artur Kaja** . Çfarë të bëj unë nuk kam fuqi që të detyroj askënd.

**Sokol Gosa** . Kryetare mos zgjatemi e kaluam për herë tjetër.

**Mukades Gixhari** . Atëherë pika 10 e rendit të ditës do shtyhet për mbledhjen e radhës do vijë të na relatojë drejtori i bujqësisë z. Elton Xhani. Kalojmë në pikën tjetër, "Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore "Haxhi Memolla" Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i listës së



aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2024”.  
Fjala për specialistin e kulturës z. Endrin Ajdini.

**Endrin Ajdini** . Përshëndetje dhe punë të mbarë për të gjithë. Besoj jeni të informuar për aktivitetet që kemi pasur për vitin 2023. Nga 35 aktivitete të parashikuara ne kemi arritur të realizojmë 19 aktivitete , ndërsa për këtë vit për 2024 ne kemi planifikuar 48 aktivitete përveç festave zyrtare që ka Republika e Shqipërisë. Unë me thënë të drejtën vjet kam parashikuar 35 aktivitete në fokus janë aktivitetet bazë që duhen për Bashkinë, ne si Qendër Kulturore nga 35 aktivitete kemi realizuar vetëm 19 aktivitete që ju i keni parë. Unë me thënë të drejtën nuk e kam arritur objektivin se kisha menduar deri 27 ose 32 aktivitete që ta përmbyllja atë sa doja. Edhe këtë vit jo pa qëllim e kam çuar nga 35 deri 48 aktivitete që mendoj që do kapim një objektiv pas takimit që kemi pasur tani dhe me pjesën e ONUX-it të Bashkimit Europian për të arritur deri në 48 aktivitete për 2024. Ndërsa për sa i përket pjesës së turizmit edhe këto i keni lexuar dhe jeni në dijeni besoj, por këtu do kemi dhe dy shtesa tjera dita e vjeljes së ullirit me bërë një panair edhe kulinarie ose për të gjitha produktet që ka zona jonë Bashkia Rrogozhinë.

**Altin Tosku** . Panairin ku do e bëni?

**Endrin Ajdini** . Panairin lemi menduar ta bëjmë tek parku edhe frutikulturës.

**Altin Tosku** . Thashë se do bëni një treg fruta perimesh se nuk keni bërë akoma.

**Endrin Ajdini** . Jo për treg është tek parku që do bëhet kurse kjo pjesa e Gërmenjit do bëhet në Gërmenj për vjeljen e rrushit është dhe një festa e domates nuk e kemi shkruar se akoma nuk është miratuar nga ... Shumë aktivitete ne kemi kërkuar disa grante nga Bashkimi Europian që mund t'i shfrytëzojmë. Dmth pa kërkuar gjëra dhe nga Bashkia kur ka mundësi dhe forma tjera mendoj që çfarë është e mirë për komunitetin do ta bëjmë të mundur kurse tani kemi një projekt javës tjetër apo pas 10 ditësh, na vjen dhe gjithë informacioni i Bashkisë për Bashkinë Rrogozhinë për gjithë ... do dalë një libër konkret siç bëmë për kalanë e Bashtovës kemi një udhërrëfyes tjetër për Bashkinë e Rrogozhinës për turistët e kemi kërkuar dhe në anglisht dhe në shqip, plus dhe itineraret që kemi vënë të gjitha pikat e bashkisë i kemi vënë itineraret vjet ka qenë në Gusht kur bëmë “Bashtova Festival “ në kalanë e Bashtovës. Deri tani turistët vijnë edhe me një “Kju” vetëm më një lançim nga telefoni shikon çfarë do vizitojë në Rrogozhinë.

**Silvana Aliu** . Atëherë të thuash që janë bërë aktivitete do të thotë që keni një grup artistik si Qendër Kulture. Ke një grup artistik? Sepse të më thuash që kam bërë festën e abetares i bie që të gjithë organizimin ti thjeshtë ke dhënë Qendrën Kulturore, e ke dhënë sepse këtë e kanë bërë



mësueset. “Aromë Xhamie” e ka përgatitur xhamia. Qendra Kulturore ka grupin artistik ti dmth Bashkia jonë ka një grup artistik?

**Endrin Ajdini** . Jemi marrë me foninë me teknikat me provat me të gjitha.

**Silvana Aliu** . Këto mund t’i marr dhe në privat s’ka ndonjë gjë. Unë vi të marr Qendrën Kulturore me qera si merret dhe këto gjërat mun t’i marr privat, kjo nuk është aktivitet. Aktivitet është kur Qendra Kulturore ka grupin artistik .

**Endrin Ajdini** . Të krijojë një grup artistik?

**Silvana Aliu** . Po.

**Endrin Ajdini** . Ne prandaj e humbëm festivalin e Gjirokastrës se nuk kishim grup artistik kur shkuam që konkuruam.

**Silvana Aliu** . Këtu thotë “Aromë Ramazani”

**Endrin Ajdini** . Po pra bashkëpunimi ...

**Silvana Aliu** . Bashkëpunimi është gjë tjetër, ti ke dhënë Qendrën Kulturore ta organizojë, ti vetë si qendër...?

**Endrin Ajdini** . Ne jemi marrë me të gjitha detajet e qendrës jo vetëm se merret ambienti, që nga fonia nga përgatitjet që nga provat ne kemi ndenjur deri në orët e vona deri ...

**Silvana Aliu** . Edhe cili është grupi që i ka përgatitur?

**Endrin Ajdini** . Në qoftë se i përgatit një mësuese grupet janë bërë tek ne edhe ne kemi ndenjur në dispozicion.

**Silvana Aliu** . E njëjta gjë që ke dhënë ambientin asnjë gjë nuk ka, të vihet grup artistik do ishte diçka më ...

**Endrin Ajdini** . Atë nuk e ve në dyshim.

**Silvana Aliu** . Atëherë i thuhet aktivitetet, që dhe aktivizohet rinia edhe del më bukur, po të



thuash këto u organizua festa e abetares, unë mund të vi të bëj dhe ditëlindje dhe ti nuk do mund të më thuash mua këtu që kam bashkëpunuar ose kam bërë aktivitet.

**Endrin Ajdini .** Kur e merr ti më fal se aty janë bërë aktivitete që e kam marrë ti përsipër dhe nuk janë shkruar fare ...

**Silvana Aliu .** Unë jam e mendimit që të ngrihet një grup artistik...

**Endrin Ajdini .** E kuptoj por të ngrejmë një grup artistik ashtu si mendohet unë nuk po shoh këtu gjithë kjo Bashki 50 mijë banorë kë do marr unë në grup artistik aty, që një profesionist po them aktor.

**Silvana Aliu .** Po, aktivizo të rinjtë, ka plot që kanë dëshirë...

**Endrin Ajdini .** Po si kush ka dëshirë?

**Silvana Aliu .** Duke filluar që tek aktivitete që bëhen në shkolla tek gjimnazi aty hë fillo dhe atyre i hynë...

**Endrin Ajdini .** Do dalim po atje ku thua ti pastaj që e ka bërë shkolla ne këtë po punojmë...

**Silvana Aliu .** Ti bëj punën tënde merri ti aktivizoji ti, jo t'i aktivizojnë mësuesit, se për aktor ti do i bësh nuk do i bëjë...

**Alime Hoxha .** Është ideja që të aktivizohen ato nxënës kush janë talente dhe të afrohen tek Qendra Kulturore që të krijohet një grup artistik. Ju keni qenë gjithmonë në bashkëpunim me shkollat kemi bashkëpunuar...

**Endrin Ajdini .** Nuk e ve në dyshim zonjë e kam për detyrë të bashkëpunoj me shkollat dhe do bashkëpunoj gjithmonë... zonja po thotë unë ta quaj grup artistik profesional ...

**Silvana Aliu .** Është pak e rëndë fjala profesionale , grup artistik pastaj fillojmë shkallë shkallë.

**Endrin Ajdini .** Profesional që ta marrim që ka mbaruar akademinë e arteve të vijë , ai quhet grup artistik nuk quhet grup artistik se nuk përfaqësohemi në festival të Gjirokastrës me nxënës shkolle.



**Silvana Aliu** . Fillo nga pak ti mos shko deri në Gjirokastrë.

**Endrin Ajdini** . Si mos shkoj do e kërkoj...

**Sokol Gosa** . Mendoj që Drini ka paraqitur shumë aktivitete por ka realizuar pak mendoj që përmbidhi Drino edhe për këtë vit nga dyzet e ca sa ke bërë për mua bëj 10 ama të jenë me taman që të ja vlejë për mua. Edhe kam një vërejtje tjetër datat nuk shikoj datat, do thuash o profesor data varen në varësi të ofertave me shkollën por e mira një farë parashikimi duhet të kishe bërë që të kishim shënuar dhe datat anash për këto aktivitete që mund të zhvillohen.

**Endrin Ajdini** . Datat që do zhvillohen?

**Sokol Gosa** . Që do zhvillohen flas për 2024 lëre 2023.

**Endrin Ajdini** . Kjo është lista e aktiviteteve pastaj me datat...

**Sokol Gosa** . Pastaj mund ta detajoje më shumë. Ti përmende fletëpalosje, ti the libër apo fletëpalosje?

**Endrin Ajdini** . Libër.

**Sokol Gosa** . Shumë mirë unë do ngre një shqetësim sot zonja kryetare, të nderuar këshilltarë në Vilë sot mund të shkosh vetëm me gomone me varkë është shqetësim për mua mjaft i madh. Dhe të mos harrojmë që gati pas një muaji dy muajsh fillon dhe sezoni turistik e ngre këtu janë dhe përfaqësuesit e administraetës së bashkisë një ndërhyrje urgjente se si do gjendet forma. Mënyra për të shkuar qytetarët që shkojnë që kanë veprimtarinë e tyre turizmin apo veprimtari të ndryshme nuk mund të kalojmë dot thonë dhe japin dhe pamje ku makinat kanë ngecur sepse ka dalë ... është vërtetë shumë shqetësuese për mua sepse përderisa e kemi këtë zonë të mrekullueshme Bashtovën apo plazhin pastaj është gjë tjetër dhe të mos kemi infrastrukturën. Prandaj Rezi nuk e di e kemi ne e ka qeveria duhet ndërhyrje urgjente. Këto kisha faleminderit.

**Mukades Gixhari** . Zonja Fatmira. Faleminderit z. Sokol.

**Fatmira Thartori** . Faleminderit zonja Kryetare. Drini tek këshilli tjetër parardhës u vendos që të bëheshin ose të bleheshin të investohej për kostumet popullore. A ka nisur kjo pjesë? Pra për kostumet që në çdo festë në çdo promovim që ti ketë qendra kulturore aty jo shkolla nuk ka punë shkolla. A është nisur kjo? Pra po ti ke qenë aty në krye të kësaj bashkë me Toskun dhe tani je



po ti, ne duam një informacion a ka nisur ky proces a do blihen kostumet popullore që ne mos i marrim ose prindërit fëmijët të gjithë mos marrin me qera por të jenë aty tek qendra kulturore. Dhe është një ide shumë e mirë do ishte mirë të vazhdonte në qoftë se e keni nisur, në qoftë se nuk e keni nisur duhet patjetër që të ...

**Endrin Ajdini** . Patjetër ne duhet të kemi shumë seriozitet ne duhet të kemi një garderobë të larmishme si qendër kulturore.

**Fatmira Thartori** . Kjo ishte ideja.

**Endrin Ajdini** . Jo vetëm këto ne duhet te kemi kostume si për veshjet tradicionale, të kemi kostume për gjuhën amtare , të kemi kostume për çdo lloj aktiviteti tjetër në bazë të... edhe moshave dhe normalisht është e mirë që t'i kemi.

**Fatmira Thartori** . Atëherë nuk është nisur akoma?

**Endrin Ajdini** . Ti e di shumë mirë që ne e kemi kërkuar sepse na duhen por unë deri sot që ne po flasim ne i kemi marrë me qera kemi gjetur formën me qera.

**Mukades Gixhari** . Z. Enver Memolla.

**Enver Memolla** . Tani duke lexuar planin dhe nga titujt dhe nga data shihet që një pjesë e tyre janë të imponuara sepse janë data historike. Dua të di ju keni vetë një plan konkret për të bërë gjëra jashtë këtij konteksti dhe datave të përcaktuara? Plan konkret për të bërë zgjerimin e aktiviteteve nga qendra kulturore sepse gjithë këto pika ju jepni vetëm objektin të kompletuar foni e të gjitha dhe të bëra nga ju nuk ka plan konkret. Nëse ma kuptove idenë... ? Çfarë do të thotë nëse këtë vit ke nxënë të rinj e të reja që merren duke i rënë kitarës violines a i ke këto në plan për t'i promovuar në një koncert t'i dëgjojmë këto? A ke një plan siç jepen në kinematë e qyteteve të mëdha filmat e rinj që shihen, dmth a ka një kërkesë midis shtëpive që bëjnë dhe këtyre producentëve që të afrohen dhe të vijnë të japin shfaqje në Rrogozhinë edhe për të ngritur frymën e kulturës por edhe qendra kulturore të afrojnë të ardhura me biletat.

**Endrin Ajdini** . Me qendrën kombëtare të kinematografisë kemi bërë tani bashkëpunim dhe këtë vit do sjellim gjithë Rrogozhina si ka qenë qëkur është ndërtuar me uzina do e sjellim tek parku por janë të gjitha në plan por nuk mund t'i përcaktoj dot fikse se kur. Edhe kemi parë dhe me "Cineplex" për t'i marrë një kontakt për filmat e rinj.





**Enver Memolla** . Ajo që ndërhyra realisht është fat që është ajo qendër kulturore sot për ne se e di çfarë ka qenë dhe çfarë është por realisht duhet të fillojë mekanizmi të lëvizë që të afrojë të ardhura.

**Endrin Ajdini** . Tani që të krijojë të ardhura ne kemi një kapacitet prej 159 vendesh atje dhe ne do na vijë një shfaqje tani në Prill quhet “Çertifikatë martesë” është Gent Zenelaj është Olta Dako janë të gjithë aktorët më të mirë.

**Enver Memolla** . Këtë po thoja.

**Endrin Ajdini** . Jam lidhur dhe me “Cineplex” për filamt e fundit që do na vijnë, tani unë shikoj dhe kapacitetin e vendeve dhe unë këto i kërkoj në forma dmth nuk i kërkoj nga Bashkia i kërkoj me biletë ose me një fond që mund ta ketë në plan Bashkimi European që ka listën e aktiviteteve kulturore e të gjitha që i kemi kërkuar. Kam kërkuar edhe info pointin e gjithë që do vihet në kalanë e Bashtovës, kushdo që do vijë vizitor ta marri atje ka vendin e vet ku do rrijë do marri skicën çfarë do vizitoj në Rrogozhinë. Unë vij në Rrogozhinë si turist ku do shkoj, kemi kërkuar dhe infopointin tani me shkop magjik nuk bëhen siç e dini unë jam maksimumi nga të gjitha Bashkitë që kam qenë në shumë mbledhje në shumë takime mund të jem i vetmi që kërkoj më shumë sepse kjo gjë është pasion i punës time në radhë të parë ju e dini shumë mirë unë e kam merak vetë këtë punë. Dhe prandaj them vjet isha 35 aktivitete bëra 19 mu duk shumë pak .

**Sokol Gosa** . Drino më fal është për të ardhur keq që ne vuajmë për talente për rrethe kulturore artistike kurse Bashkitë tjera i kanë, prandaj ti je i detyruar se t’i kesh vetë këto është...

**Endrin Ajdini** . Do bëj festën e çlirimit unë do marr bandën e Tiranës ...

**Sokol Gosa** . Të kesh një artist të kesh një këngëtar të kesh një grup etj, se këto i kanë ne si kemi dhe ti detyrohesh pastaj të sforcohesh duke kërkuar.

**Endrin Ajdini** . Do kërkojmë ... jo nuk e vuajmë vetëm ne si Bashki, ka shumë Bashki të vogla që e vuajnë psh, e vuan Rroskoveci e vuan Lushnja e vuan edhe Lushnja.

**Alime Hoxha** . A u plotësuar me staf aty tek...? Sepse kërkonit një muzikant siç ishte ai që merrej me nxënësit me fëmijët.

**Endrin Ajdini** . Akoma nuk ka ardhur.



**Alime Hoxha** . Këtu keni bërë një plan që thotë maratona “Këngë Moj”.

**Endrin Ajdini** . Maratona “Këngë Moj” vjen nga jashtë nuk ka lidhje me ... këtë e jep Vizion Plus që ne e ftojmë për tek parku...

**Sokol Gosa** . Drino si ka mundësi kur ishte ai kryetari tjetër për çdo vit mbaj mend unë çdo verë mbushej parku me këto maratona e çfarë janë këto.

**Endrin Ajdini** . Popullore por tani është ndryshuar është bërë “Këngë Moj”.

**Sokol Gosa** . Si ka mundësi? Aq mungesë vizioni. që ky qytet kaq i varfër për anën kulturore shyqyr që nga ana sportive që po na dëgjohej emri përditë. Kurse nga ana kulturore mos bëhet një aktivitet mos harro vit për vit ai që ka qenë sillte...

**Endrin Ajdini** . Po pra na qëlloi pandemia nuk është se...

**Sokol Gosa** . Ashtu qoftë.Po shikoje ishalla e sjell në Korrik.

**Endrin Ajdini** . Çdo gjë unë do sjell këtu se ...

**Silvana Aliu** . Edhe diçka nuk ke nevojë të sjellësh nga Tirana, nxirr një nga qyteti që mund ta aktivizosh, do më sjellës ti mua e shoh dhe në televizion unë atë dhe video sa herë të më shkrepet. Çfarë po bën ti për rininë që po bën një qendër kulture? Se këto që ke bërë ti këtu këto janë pa lidhje të thuash “Nata gala me artistë dhe ish futbollistë” të Rrogozhinës i bie që ne ja kemi kaluar Tiranës.

**Endrin Ajdini** . Tiranës ja ke kaluar sot që po flasim, natës gala për ndeshje ja ke kaluar Tiranës sepse je në vend të parë sa për dijeni, ka lidhje qyteti.

**Silvana Aliu** . Unë po them çfarë ke bërë për rininë?

**Sokol Gosa** . Drino ke dhe përvjetronin e Egnatias mos harro.

**Endrin Ajdini** . Po pra me atë nata gala po them zysha.

**Silvana Aliu** . E dini për çfarë shërben Qendra Kulturore? Për të tërhequr të rinjtë që të formojnë grupin, ai thotë nuk kam unë profesionistë. Më fal atë muzikantin që ke pasur ti ka shkollë të lartë?



**Endrin Ajdini . Po.**

**Silvana Aliu . E sigurtë?**

**Endrin Ajdini .** Po dhe ai sot është mësues tek shkolla “Hilary Clinton” Kamëz, profesor muzike.

**Mukades Gixhari . Z. Rezart.**

**Rezart Vogli .** Pak më parë zysh Fatmira ceku në lidhje me veshjet artistike tek pallati i kulturës është një zë që ne e miratim në buxhet është një premtim që do mbahet dhe kemi premisa nga ana Bashkisë që së shpejti kostumet dhe veshjet artistike popullore tradicionale do të kompletohet ai pallat kulture. Ashtu siç kompletuam dhe pjesën e klasës muzikore faktikisht ai bashkëqytetari jonë u largua drejt Tiranës kjo jo për fajin tonë...

**Endrin Ajdini .** Tani po ikin të gjithë nga Shqipëria nuk e mbajmë dot me zor.

**Fatmira Thartori .** Doja Rezi shyqyr që është një nismë që po vazhdon dhe jo u shtrua dhe mbeti në letër.

**Endrin Ajdini .** Psh për librin unë kam punuar 6- muaj për atë libër se këto janë gjëra që nuk është kanal që do pastrojmë kanal, do studim, do arkeolog, do historianë po kap Kalanaë e Bashtovës se zysha e di për të nxjerrë diçka më të bukur. Unë më mirë e vonoj diçka tre muaj 6 muaj dhe ajo që të vijë të vijë profesionale dhe të vijë aty ku duhet se për mua është turp kam kaq vite të bëj këto mua nuk më lejohet në mënyrë kategorike me bërë gabime. Tani këshilla sa të duash, gabime të gjithë gabimtar jemi por unë mundohem prandaj them edhe këshillat i pranoj me kënaqësi të madhe nuk mendoj që kam arritur kam bërë asgjë por ato që bëj për mua nuk është asnjë gjë sepse duhet të jap gjithjmonë e më shumë kjo është detyra ime tek Qendra Kulturore.

**Mukades Gixhari .** Faleminderit.

**Rezart Vogli .** Në lidhje me aktivitetet artistike që ka ndërmarrë pallati i kulturës vitin e kaluar është ndërmarrë nga stafi i pallatit të kulturës një aktivitet gjithëpërfshirës besoj i të gjithë shkollave të bashkisë Rrogozhinë u dhanë dhe disa tituj simbolikë dmth ishte promovim i qendrës kulturore që këto nxënësi i vuri në pah. Tjetër gjë aktivitet që është ndërmarrë në Qendrën Kulturore ka qenë dhe arte dhe zeje në bashkëpunim me shoqatat dhe isjhte një aktivitet që u zhvillua në parkun e qytetit.



**Endrin Ajdini** . E kemi përshkruar dhmt jo të gjitha çfarë bëhen tek kinemaja se po... Tani unë kam dy favore shrytëzohj Kalanë e Bashtovës, shfrytëzohj Spillenë, shfrytëzohj parkun e qytetit dhe Qendrën Kulturore. Këto të gjitha janë aktivitete kulturore mendoj unë se nuk mund t'i bëjmë të gjithë aktivitetet tek qendra kulturore. Qendra Kulturore është që i thashë dhe Verit që ne me Cineplex kemi marrë kontakte dhe "Çertifikatë Martese" do jetë shfaqja që do vijë shumë shpejt siç ju thashë me Driata Dervishin, kështu që jeni të ftuar të gjithë do ju sjell ftesat vetë.

**Sokol Gosa** . Faleminderit.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit Drini. Kalojmë tek pika 12, Të ndryshme. Kthim përgjigje nga Sektori Juridik pranë Bashkisë mbi propozimin e bërë nga dy Këshilltare që fshati Kalush Nj. A Gosë të bëhet me dy kryetarë fshati. Materialet i keni përpara. Atëherë fjala është për përgjegjësin e sektorit juridik z. Luan Gjuzi.

**Luan Gjuzi** . Referuar shkresës tuaj nr, 408 që fshati Kalush të kthehet me dy kryetarë fshati me shkresë nr.408/1 ju kemi kthyer përgjigje nuk e di a e keni informacionin e saktë pyetaje a keni.

**Fatmira Thartori** . Është kthyer përgjigje, në mënyrë që kanë nënshkruar dy këshilltare që kanë qenë aty të pranishme por arsye pse nuk është?

**Luan Gjuzi** . E kam sugjeruar që nuk mund të bëhet të paktën me iniciativë të zyrës juridike të bashkisë. Nuk kemi të drejtën e nismës iniciativës për të propozuar për ndarjen e fshatit, në dy fshatra se emërtesat bëhen me vendim këshilli. Dhe rregullimi grupimi i vetëqeverisjes vendore është bërë me ligjin 115/2014.

**Fatmira Thartori** . Po e njëjta gjë ka ndodhur tek një fshat Gosë e Vogël.

**Luan Gjuzi** . Po, Gosa Vogël është rregulluar nga akti juridik i trashëguar me ligjin 8652 neni 8 kur ka qenë ish komunë.

**Fatmira Thartori** . Në mandatin tjetër ka qenë vetëm një kurse tani në këtë vit...

**Luan Gjuzi** . Jo ka qenë ajo edhe vjet ka qenë edhe mandatin e 2019 ka qenë, ka qenë Rrahman Balliu.

**Fatmira Thartori** . Se kemi ditur ne.



**Luan Gjuzi** . Rregullimi juridik është bërë me ligjin 8652 ka ekzistuar Komuna Gosë.

**Fatmira Thartori** . Ne themi nuk jam në kundërshtim që janë dy aty, them po ketu matanë pse mos bëhen dy. Pra kur u bënë këtu...

**Luan Gjuzi** . Nuk mundet .

**Besnike Coraj** . Kur sipërfaqja është dhe numri i banorëve është më i madh kjo ishte...

**Luan Gjuzi** . Nuk mund t'i vesh emërtesë tjetër. Kalushi një Kalushi dy.

**Besnike Coraj** . Po Gosa Vogël?

**Luan Gjuzi** . Gosa Vogël është rregullar me 8652.

**Besnike Coraj** . Ka mbaruar ky proces?

**Luan Gjuzi** . Ka mbaruar që kur ka qenë komunë.

**Silvana Aliu** . Porcesi i të gjithë kryeqepve ka mbaruar?

**Luan Gjuzi** . Situacionin e parë jua dhashë unë ka mbaruar Kryevdhi, Sinaballaj...

**Indrit Dedej** . Ne kemi informacion nuk kemi informacion fare veç Sinaballaj.

**Enver Memolla** . Afati i këtyre ka qenë 15 Tetor në mos gaboj ka pasur një afat kohor.

**Luan Sheshi** . Informacionin për zgjedhjen e strukturave komunitare jua kam sjellë Sinaballaj ka mbaruar, Gosa ka mbaruar, Lekaj aktualisht është në proces zgjedhor në Kryevdhi është vetëm një.

**Lulzim Hasa** . Zgjedhje nga më të rregulltat janë bërë në Kryevdhi. Një ka ngelur vetëm sepse atë ditë që do bënim atë gati vdiq ai. Janë bërë zgjedhje me video me të gjitha në Kryevdhi janë bërë zgjedhjet më korrekte që ekzistojnë, pjesëmarrja janë njoftuar të gjithë banorët e fshatit.

**Luan Gjuzi** . Ju jeni përfaqësuesit e vetë këshillit ju i monitoroni mos më kërkoni ne, prandaj po them kush kanë qenë përfaqësuesit.



**Mukades Gixhari** . Kush është ankuar?

**Saimir Cani** . Janë ankuar banorët... (pjesa tjetër nuk dëgjohet).

**Silvana Aliu** . Banorët janë ankuar që kryetari i bashkisë ka vënë atë që ka dashur.

**Fatmira Thartori** . Po nuk ka punë kryetari aty ju jeni mbledhur vetë.

**Sokol Gosa** . Këto janë formalizma.

**Enver Memolla** . Komisioni i këshillit bashkiak ka firmosur? Kush janë anëtarë të këshillit bashkiak që janë atje?

**Mukades Gixhari** . Saimiri nuk është pjesë?

**Enver Memolla** . Atëherë Saimir ke të drejtë mbledhjen e radhës t'i kërkoh komisionit përkatës ë marrësh informacionin e duhur për Njësinë Lekaj. Thorre në interpelancë komisionin përkatës.

**Lulzim Hasa** . Kryetare ne kemi miratuar komisionet për çdo Njësi, jemi nga tre veta, të gjithë kemi firmosur në procesverbalet përfundimtare dhe çfarë ka këtu?

**Enver Memolla** . Nga një përgjigje që prisnim nga dy zonjat këshilltare, tani po del që edhe afatet kohore janë kaluar për zonat tjera...

**Luan Gjuzi** . Është në proçes.

**Enver Memolla** . Çfarë proçesi, ka pasur një afat kohor 30 Tetor në mos gabohem, sepse bllokimi i procesit po penalizon dhe qytetin e Rrogozhinës se akoma nuk janë vendosur...

**Luan Gjuzi** . Rrogozhina ka strukturë tjetër qytet nuk është fshat, Bashkia Rrogozhinë është e ndarë në 4 blloqe banimi , 2 lagje 4 blloqe dhe kur është qytet i takon që te jetë administrator i njësië që do të thotë Bashkia Rrogozhinë ka vënë 4 administratorë me kompetencat e kryeplakut.

**Enver Memolla** . Emërohen nga kryetari i bashkisë?

**Luan Gjuzi** . Direkt.

**Enver Memolla** . Kaq doja të dija.



**Luan Gjuzi** . Ka strukturë tjetër zgjedhjeje ato kanë kompetencat e administratorit.

**Enver Memolla** . Je në rregull, e kuptova.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit z. Luan. Kthim përgjigje nga Drejtoria Rajonale OSSH Durrës mbi ankesën e bërë nga Këshilli Bashkiak mbi problematikën e ndërprerjeve të energjisë elektrike. Kemi kthim përgjigje.

Për sa i përket ankesës me Nr.Prot. 4311 të bërë nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Rrogozhinë ju sqarojmë se :

Në zonën Kryevidh, Gosë, Lekaj, Sinaballaj të cilat i përkasin Njesisë administrative të Rrogozhinë e cila furnizohet me energji nga Nst.35/10 kv Rrogozhinë nuk ka patur ndërprerje të energjisë elektrike pa arsye. Ndërprerja e energjisë ka ardhur gjithmonë si pasojë e defekteve në LTU dhe LTM. Zona që furnizohet nga Nst. 35/10 kv Rrogozhinë është shumë e gjërë dhe linjat LTM dhe LTU që furnizojnë këto zona janë ajrore shumë të gjata. Defektet në LTM në zona të ndryshme bëjnë stakimin e fiderit në N/Stacion, kështu që për pak kohë mbetet pa energji i gjithë fideri deri në lokalizimin e defektit. Ndërprerje të energjisë kanë ndodhur edhe në ditët edhe në ditët me mot me erë dhe shi, mot që ndikon në linjat ajrore. Në të gjitha këto zona janë bërë investime të konsiderueshme që kanë rritur cilësinë e furnizimit me energji si dhe nivelin e tensionit. Edhe niveli i tensionit është brenda parametrave të lejuara në të gjithë zonën.

Punonjësit e Njesisë kanë qenë gjithmonë në gatishmëri për riparimin e defekteve të ndodhura në zonë dhe kanë punuar me përkushtim për eliminimin sa më të shpejtë të tyre.

Në të gjithë zonën që furnizohet nga N/stacioni 35/10 kv Rrogozhinë po vazhdojnë investimet në LTM dhe LTU për të përmirësuar rrjetin e shpërndarjes duke kthyer pjesën më të madhe të linjave ajrore më kabull ABC, gjë e cila përmirëson dukshëm nivelin e tensionit dhe ul shumë numrin e defekteve. Lutemi edhe për mirëkuptimin e banorëve duke theksuar që zona në fjalë është shumë e shtrirë në terren.

Faleminderit, Specialisti Ing. Bledar Gjuzi.

Tani çfarë keni ndonjë gjë tek të ndryshmet.

**Enver Memolla** . Zonja kryetare kam një pyetje të drejtpërdrejtë. Ka mbaruar mbledhja e këshillit bashkiak?

**Mukades Gixhari** . Jo.

**Enver Memolla** . Pse drejtorat e bashkisë po largohen? Se nuk di kë të pyes tani nuk kam asnjë.

**Sokol Gosa** . Vetëm Rezi ka ngelur, i përhershmi.



**Fatmira Thartori** . A mund të bëj një pyetje znj. Kryetare? Atëherë doja të pyesja për atë informacionin që ne e kemi kërkuar si Këshill për energjinë elektrike ne kemi pyetje kush do të na japë përgjigje. Ajo është përgjigje e cunguar nuk është përgjigje që duhet patjetër të na thoshte arsyet ato nuk janë arsy, ato vetëm thjeshtë mbulojnë pjesën e vet sepse arsye ato nuk janë. Kush do na kthejë përgjigje?

**Silvana Aliu** . Atëherë në lidhje me atë që patëm për projektin “Tungjatjeta Jetë” për fëmijët me aftësi ndryshe. Tani për të marrë më tepër informacion shkova tek bashkia dhe mënyra e të folurit të vajzave që merreshin me atë projekt ishte harbutçe, sikur po flisnin me një të rrugve. Tani unë kam kërkuar mirë që nga fëmijët flas gjithmonë më falni për qytetin e Rrogozhinës nga fëmijët që ishin në qytetin e Rrogozhinës 4 fëmijë një vit kishin ikur në Itali dhe ishin ndjekur nga këto a e kanë bërë online fizioterapinë , gjërat i kanë bërë online. Fëmijët janë pajisur të gjithë me diagnozë por diagnozën nuk e kanë në shkollë . Diagnoza e një fëmije me probleme është si pashaportë jepet dhe ky fëmijë nuk ka shërbimin prej dy vitesh këto fëmijë nuk e marrin. Lekun e marrin ato se do paguheshin, shërbimi nuk i shkon e kanë marrë fëmijën e kanë çuar në Kavajë e kanë vizituar i kanë dhënë me ekzemë në kokë që një fëmijë 10 - vjeçar me ekzemë kuptojeni vetë ai që është prind, i kanë dhënë thjeshtë një shampo dhe nuk e kanë parë më atë fëmijë. Dhe përgjigja e atyre ishte që më mjeton që më ka ardhur vetëm njëherë, dmth gjatë gjithë vitit mjaftonte që ai të vinte vetëm njëherë. I kam pyetur nëse ju shkoni pranë këtyre fëmijëve me i dhënë fizioterapinë dhe çfarë i duhet këtij fëmije, përgjigja ishte jo sepse nuk e dinin këtë fëmijë. Tani ky fond ku shkon? Përderisa këtyre fëmijëve nuk i jepet shërbimi nuk i bëhet fizioterapia për çfarë duhet? Është një projekt i dështuar dhe ne dhamë lekët. Se ta pajisësh një fëmijë me epilepsi do të thotë që ai fëmijë ka diagnozën dhe në shkollë por njëkohësisht merr dhe një KEMP, ai fëmijë nuk figuron fare në shkollë dmth thjeshtë është fëmijë normal. Kjo diagnozë si ka dalur?

**Mukades Gixhari** . Po z. Enver. Faleminderit zonja Silvana.

**Enver Memolla** . Në radhë të parë faleminderit zonjës Silvana, pavarësisht bindjeve politike fëmija është fëmijë. Unë propozoj që personat përgjegjës që merren me këtë punë të jenë në mbledhjen e këshillit bashkiak këtu dhe të japin të gjithë itinerarin e punës së tyre si e bëjnë si nuk e bëjnë deri tek certifikata si thotë dhe Silvana ...

**Silvana Aliu** . Si e kanë marrë?

**Enver Memolla** . Sepse realisht duhet ta dimë dhe ne si funksionon kjo organizatë...





**Mukades Gixhari** . Të lutem muajin tjetër të jenë prezentë.

**Alime Hoxha** . Këtë pjesën e certifikatës mjekësore nuk e kishin?

**Silvana Aliu** . Nuk e ka fëmija në shkollë se normalisht duhet ta ketë.

**Alime Hoxha** . Nuk e ka në shkollë dhe e ka në bashki?

**Silvana Aliu** . Përderisa fëmija është me epilepsi dhe me zhvillim të prapambetur do të thotë që këtë e ka që në lindje nuk e ka.

**Fatmira Thartori** . Diagnozën e përcakton doktori e përcakton komisioni.

**Silvana Aliu** . Më fal e ka përcaktuar vetëm kur ka ardhur projekt, se fëmija 8 vite që është në shkollë nuk e ka.

**Alime Hoxha** . Pra tani ky ka çuar certifikatën tek bashkia tek këto që kanë projektin?

**Silvana Aliu** . Unë i kam kërkuar Rezit të më sjelli sot diagnozat dhe nuk mi ka sjellë. Unë dua ta di si ka dalë.

**Besnike Coraj** . Nëse është i diagnostikuar fëmija që i vogël patjetër që ka kartelë mjekësore.

**Silvana Aliu** . Se ka.

**Besnike Coraj** . Patjetër qendra shëndetësore mjeku i familjes që e mbulon ka të gjithë sepse ai merr një mjekim specifik nuk merr mjekim si gjithë të tjerët ai mjekim nuk jepet në rast se nuk e ke...

**Silvana Aliu** . Nuk e ka po flas që nuk e ka certifikatën. Janë fëmijë që janë marrë kur ka ardhur projekti janë çuar në Tiranë diku i është bërë një diagnozë...

**Besnike Coraj** . Kush i ka diagnostikuar fëmijët?

**Silvana Aliu** . Nuk e di Rezi të japë përgjigje.

**Mukades Gixhari** . Ta dëgjojmë drejtorin e financës .



**Indrit Dedej .** Ku i kanë letrat shkon në punë ti...

**Silvana Aliu .** Kërkova një dosje dhe gjëja e parë në dosje është diagnoza.

**Fatmira Thartori .** Atëherë dosjet e këtyre fëmijëve kështu nuk jepen nuk lëshohen përveçse mjeku i familjes ka të drejtë.

**Silvana Aliu .** Në momentin që fëmija shkon në shkollë sepse ka nevojë për mësues ndihmës jepet diagnoza . Kur katër fëmijë kanë ikur jashtë shtetit ku e kanë marrë shërbimin 1 vit nga 16 orë mund të rrinin 3 në qoftë se nuk ka fëmijë. Unë për këtë jam do japim lekë t'i mbajmë aty në zyrë apo të shkojë shërbimi tek fëmija? Se unë e di shumë mirë çdo të thotë fizioterapi se ndjek vetë fëmijën e di shumë mirë çdo të thotë sa harxhohen. Po kur ti nuk jabën kur ti ke 5 fëmijë të komunitetit egjiptian që nuk marrin asnjë shërbim, janë të verbër kanë ekzemë, janë me çrregullime mendore s'kanë këta fëmijë njëherë m'i kanë marrë tha sa i kanë çuar tek mjeku dhe nuk i kanë marrë më.

**Rezart Vogli .** Përsëndetje të gjithëve! Në lidhje me rastin, shqetësimin e zonjës Silvana unë jam në dijeni jemi takuar dhe bashkë. Njëherë në radhë të parë do të kërkoj ndjesë sepse stafi i Bashkisë të janë përgjigjur keq si po më thua, fill pas takimit tuaj kam pasur dhe mbledhje takim me ato. Gjithsej janë 36 fëmijë të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor, diagnozën e lëshon mjeku ato vajza nuk kanë diagnoza, fëmijët janë referuar në mbështetje dhe me bashkëpunim të drejtorive të shkollave përkatëse. Në lidhje me diagnozat e secilit fëmijë duke qenë se janë minorenë dhe janë sensitive të dhënat , unë do propozoja nga këshilli bashkiak ngreni komisionin dhe mirë se të vini nesër në ambientet e bashkisë Rrogozhinë, shikoni dosjet për 36 fëmijët që janë aty. Secilën dosje për periudhën që janë trajtuar, si janë trajtuar nga ana e stafit të bashkisë Rrogozhinë.

**Indrit Dedej .** Ngreni komisionin ju jeni mësuese..

**Rezart Vogli .** Ngreni komisionin do ju mirëpres unë në momentin që do vini në bashki do ju shoqëroj unë dosjet do jua ve në dsipozicion po unë si drejtor i financës dhe shërbimit social . Duke qenë se janë fëmijë minorenë besoj se është pak sensitive t'i nxjerrim të dhënat e tyre, jeni dakord me mua besoj.

**Silvana Aliu .** Në momentin që fëmija ka diagnozë e ka dhe në shkollë dhe ndiqet nga mësuesi special, mësuesi ndihmës dhe fëmija në rregull jam dakord këtyre fëmijëve do t'i jepni që sot KEMP-in sepse paska diagnozë ai do marrë 90 mijë lekëshin.



**Rezart Vogli** . Do të them vetëm kaq ka fëmijë, ka dhe familjarë që nuk duan që fëmijët e tyre të trajtohen...

**Silvana Aliu** . Jo se prindi ka ardhur dhe më ka thënë ma merr fëmijën ma ço tek mjeku nuk dua asgjë.

**Rezart Vogli** . Më dëgjo dhe mua deri në fund fare dhe pastaj vlerësoje vetë. Ka prindër të cilët nuk pranojnë t'i çojnë fëmijët nëpër qendra ku t'i ofrohet shërbimi por duan që shërbimin ta marrin në shtëpi.

**Alime Hoxha** . Puna është se e kemi pyetur gjithmonë ky shërbimi në shtëpi funksionon?

**Rezart Vogli** . Po patjetër.

**Alime Hoxha** . Funksionon është i mbikqyrur?

**Rezart Vogli** . Patjetër.

**Indrit Dedej** . Komisioni e kontrollon çfarë pune kabërë sot, çfarë pune ka bërë para 1 muaji.

**Silvana Aliu** . Kam shkuar i kam kapuar kanë thënë vetëm njëherë na kanë ardhur tek xhamia dhe nuk na kanë parë më, kaq.

**Altin Tosku** . Qendrën e shërbimit ku e kanë?

**Rezart Vogli** . Qendër shërbimi nuk ka. Unë e kam thënë dhe mbledhjen e kaluar dhe shumë mbledhje të tjera më parë, ne falenderojmë myftininë e Bashkisë Rrogozhinë të cilët na kanë lejuar atë ambientin ku ofrohet shërbimi për disa fëmijë, disa fëmijëve të tjerë i ofrohet shërbimi në shtëpi siç janë fëmijët që janë në zona të largëta si Kryevidhi, Lekaj, Gosa.

**Besnike Coraj** . Fatmira radhës tjetër tha dhe më pëlqeu në shkolla.

**Rezart Vogli** . Sivjet që flasim bashkë i është drejtuar nëpërmjet zyrës arsimore të bashkisë Rrogozhinë shkresë të gjithë drejtorëve të shkollave të bashkëpunojmë të na referojnë nëse ka raste të tjera që vajzat të kryejnë shërbimin. Çdo vit i drejtojmë shkresë.

**Besnike Coraj** . A kanë dokumentacion që marrin KEMP, a kanë diagnoza nga specialistët?



**Rezart Vogli .** Ka fëmijë që marrin KEMP, janë 36 fëmijë, 36 dosje.

**Silvana Aliu .** Duhet të më ndihmosh Besnike. Në momentin që fëmijës i del epilepsi dhe çrregullime prapambetje mendore do të thotë që paguhet?

**Rezart Vogli .** Si paguhet?

**Silvana Aliu .** Paguhet me KEMP.

**Rezart Vogli .** O zysh Silvanë nuk e nxjerr Bashkia diagnozën atë e nxjerr KEMP.

**Silvanë Aliu .** I keni marrë në makinë bashkë me drejtorin e shkollës i keni çuar në Tiranë i keni bërë diagnozën sa filloi projekti.

**Rezart Vogli .** Nuk bëhem pjesë e asaj skeme unë.

**Enver Memolla .** Rezi kam një pyetje, kjo godina këtu ka zyra bosh kjo godina ku jemi ne këtu, aktualisht ka zyra bosh?

**Rezart Vogli .** Duhet të jenë 1-2 zyra.

**Enver Memolla .** Duhet të jenë 3.

**Ervis Shera .** Një ka mbetur.

**Enver Memolla .** Prandaj po them kur ke zyrën bosh pse mos i bësh seancat këtu brenda në godinën tënde.

**Silvana Aliu .** Më falni një fizioterapist është lëvizës, mesa di unë ...? Merr mjetet përditë ...?

**Fatmira Thartori .** Mirë le të jetë i lëvizshëm por ne ta monitorojmë këtë pjesë.

**Enver Memolla .** Tani unë di që këtu janë drejtori të bashkisë Rrogozhinë, a nuk është e mundur që drejtoritë të lëvizin atje dhe ajo që është për të bërë këtë pjesë të vijë këtu dhe ta bëjë këtu seancën? Duke patur zyrën poshtë, atë e përdor për sallë për dhomë trajnimi ndërkohë që zyrën tjetër e ke për këtë punë.



**Rezart Vogli** . Sot jemi para faktit që po themi janë apo nuk janë ato dosje të vërteta.

**Enver Memolla** . Nuk po merrem me faktin e dosjeve unë po merrem me shërbimin, duke patur zyra bosh godina këtu.

**Rezart Vogli** . Zysh Silvana me të drejtë aty e ka problemin, se ka ardhur dhe e ka ngritur shqetësimin me të drejtë.

**Enver Memolla** . Unë po kapem tek shërbimi jo tek Silvana.

**Silvana Aliu** . Kur ne kemi tre vjet që një nxënës në shkollën tonë nuk po e bëjmë dot me letra, ju dilni si bashki që e keni me letra, na i jepni ato letra t'i marrim në shkollë dhe jemi në rregull.

**Rezart Vogli** . Do ju lutesha jo më kot erdha dhe ndenja deri në fund siç do mbledhje tjetër dhe i propozoj këshillit bashkiak ngritjen e komisionit paraqitjen pranë zyrës së shërbimit social të bashkisë Rrogozhinë dhe unë ju ve në dispozicion 36 dosje për 36 fëmijë të bashkisë Rrogozhinë.

**Silvana Aliu** . Kanë grafik ku shkojnë?

**Indrit Dedej** . Tani ne nuk do i rrimë roje atyre do komision ngremë komisionin shko verifiko dosjet.

**Fatmira Thartori** . Jo vetëm për dosjet por dhe për planifikimin pastaj çfarë zhvillojnë ato.

**Alime Hoxha** . Do isha që ato t'i bëjnë shërbime dhe atyre fëmijëve që nuk e kanë kartelën nuk është e thënë që ato të ndihmojnë nxënësit...

**Rezart Vogli** . Zysh ai staf atje nuk është i informuar kush fëmijë e ka dhe kush nuk e ka kartelën, ai staf informohet nëpërmjet drejtorive të shkollave përkatëse.

**Alime Hoxha** . Nga drejtoritë e shkollës kanë marrë informacionin që këta fëmijë kanë këto probleme,

**Rezart Vogli** . Fiks këtë javë që flasim ne kanë ardhur shumë shkresa nga drejtorët e shkollës.

**Alime Hoxha** . Nuk është me patjetër kusht që këta duhet të kenë kartelë, që ato duhet të vijnë në ndihmë.



**Rezart Vogli** . Nëse ato referohen për të ju dhënë shërbim përse jo.

**Alime Hoxha** . Kështu që nuk besoj se qëndron...

**Indrit Dedej** . Sa shkojnë tek fëmijët?

**Alime Hoxha** . Ajo është tjetër problem.

**Fatmira Thartori** . Ne aty e kemi interesin që të shkojnë tek fëmijët.

**Besnike Coraj** . Diagnozë epilepsi e di çfarë do të thotë?

**Rezzart Vogli** . Nuk e vendos stafi diagnozën ka mjekë, ka komision.

**Sokol Gosa** . Mos e zgjasim Vana ngreni komision ...

**Rezart Vogli** . Po, mirë se të vini që nesër.

**Fatmira Thartori** . Unë do të propozoja Tashën (Besnike Coraj) meqenëse është dhe për këtë pjesën që e njih mirë këtë pjesën e mjekësisë.

**Indrit Dedej** . Këto komisionet janë të dobishme dhe për Bashkinë, na konsiderojnë ne sikur jemi... ne i ndihmojmë ato.

**Mukades Gixhari** . Keni ndonjë gjë tjetër që ju ka ngelur merak?

**Sokol Gosa** . Po diçka kisha meqë jemi tek të ndryshmet. Problematika të qytetit tonë që duhet më shumë angazhimi i bashkisë tek rrugët që janë të amortizuara, të vjen keq kur shikon dhe gropa në mes të qytetit në xhaden kryesore vetëm për pak asfalt që të mbulohen. E para për rrugët e dyta pastaj ndriçimi të vendosen ato ndriçueset se ka rrugë apo lagje që mungojnë janë djegur janë thyer, janë gjëra që janë shqetësuese, vërtetë duken të vogla por janë tepër shqetësuese. Kisha dhe diçka për antenat se u hap objekti për tokat bujqësore, do propozoja ose do kërkoja Viso ato antenat që kemi tek pallatet tona, të gjendet mundësia vendi se ku mund t'i çojnë ato kompanitë e telefonive celulare sepse janë tepër tepër të dëmshme. Kemi vite vite edhe më përpara e kemi kërkuar këtë gjë por duhet të zhvendosen nga aty, këto kisha. Faleminderit.

**Fatmira Thartori** . Për sa i përket bujqësisë unë do doja të ngrehet një komision që të



monitorojmë të gjithë procesin e kanaleve kulluese më tepër se këto të pastrimit të paktën i paskan bërë, t'i monitorojmë. Ne jemi zonë rurale zonë bujqësore ne vetë në përgjithësi që të gjithë kemi toka.

**Mukades Gixhari** . Në rregull jeni dakord për ngritjen e një komisioni?

**Sokol Gosa** . Patjetër.

**Mukades Gixhari** . Kë propozoni?

**Sokol Gosa** . Hekurani që është...

**Mukades Gixhari** . Hekurani e ngriti jo më larg se dje.

**Indrit Dedej** . Nuk e marr fare Hekuranin propozoj vetë Saimirin ...

**Fatmira Thartori** . Do jem edhe unë.

**Enver Memolla** . Atëherë Altini për Rrogozhinën...

**Fatmira Thartori** . Të bëjmë një grup.

**Mukades Gixhari** . Atëherë Komision : Enver Memolla, Indrit Dedej, Hekuran Xhani, Fatmira Thartori, Saimir Cani... Hekurani se ka tokat në Luz.

**Enver Memolla** . Indrit unë propozoj Fatmirën, Altin Toskun dhe Enver Memolla, më jep dy të tutë?

**Indrit Dedej** . Dhe unë propozoj Saimir Canin, Indrit Dedejin.

**Fatmira Thartori** . Qëlimi jonë është t'i vejmë në lëvizje t'i shkundim pak.

**Enver Memolla** . Tani kemi në dorë ne t'i thërrasim ulemi të pestë, të bëjmë planin e punës tonë dhe t'i thërrasim tjerët jo kështu.

**Mukades Gixhari** . Diskutime të tjera?



**Enver Memolla** . Zysha dhe diçka, pavarësisht se u ngrit komisioni por realisht për pjesën e bujqësisë të paktën këtu është Rezi ka ardhur gjithmonë por realisht duhet pak seriozitet. Unë përse pyeta qëparë mbaroi mbledhja apo jo?

**Mukades Gixhari** . Mbledhjen e radhës do ja bëjmë me dije që të gjithë drejtorave që të qëndrojnë deri sa të mbyllim zyrtarisht mbledhjen. Po Silvana.

**Silvana Aliu** . Atëherë duke qenë se po vjen 7-Marsi ...

**Enver Memolla** . Po tetën?

**Silvana Aliu** . Nuk ka Bashkia ndonjë fond që mësuesin më të mirë në çdo shkollë i jepet pak figura një certifikatë një buqetë me lule...

**Altin Tosku** . Do politizohet...

**Silvana Aliu** . Jo nuk ka lidhje fare ajo sepse mësuesi më i vjetër...

**Fatmira Thartori** . Mësuesët më të vjetër se ne kemi të paktën dy që na dalin në pension këtë vit.

**Rezart Vogli** . Në dijeninë timë unë di që çdo vit kryetari i bashkisë përshëndet mësuesit a i dhuron buqeta me lule por nëse do duhet diçka më tepër me një kërkesë drejtuar këshillit bashkiak...

**Silvana Aliu** . Krahut tim nuk i ka dhënë asnjë herë kryetari prandaj po them.

**Rezart Vogli** . Kërkoj ndjesë do të kemi parasysh këtë vit.

**Silvana Aliu** . Nuk kemi nevojë buqetën me lule ta sjelli kryetari, a mundet mësuesi më i mirë të jetë...

**Rezart Vogli** . Nëse ti propozon diçka më shumë, mirë që në këtë këshill bashkiak ka shumicë mësuesish pse jo...

**Alime Hoxha** . Duhet të gjesh kriteret kuësh është mësuesi më i mirë?!





**Silvana Aliu** . E gjej unë, rrini ju se e gjej unë.

**Fatmira Thartori** . Këtu do i ngelë qejfi shumë mësuesve.

**Altin Tosku** . Atëherë më falni lagjja “Çetë” janë 9 familje që është bllokuar një rrugë, e cila ka qenë 30 vjet sa e mbaj mend unë që kam qenë tek ajo lagje, është bllokuar nga pronari i tokës. Se nga doli pronari i tokës tani pas 30 viteve, të paktën Bashkia duhet ta lerë hapur deri në një zgjidhje midis palës pronar dhe bashkisë.

**Enver Memolla** . Tek dyqani i Bim Hoxhës.

**Altin Tosku** . Ajo duhet të kishte ardhur me ankesë sot se unë e di që janë ankuar 9 familjekanë bërë ankesë nuk e di dmth është pjesa mes pronarit dhe Bashkisë. Se aty mund të ketë një konflikt i cili nuk është i mirë .

**Indrit Dedej** . Të ngrihet komisioni i konflikteve...

**Enver Memolla** . Është komisioni i konflikteve.

**Indrit Dedej** . Të bëjë një kërkesë komisioni është ta kalojmë në këshill.

**Rezart Vogli** . Të sqaroj diçka para pak kohësh në këshillin bashkiak të kaluar ka ardhur propozim nga ana e bashkisë Rrogozhinë për një shpronësim toke, është kthyer mbrapsht nga ana e Prefekturës pasi nuk ishte kompetencë e Bashkisë Rrogozhinë shpronësimet e tokave...

**Enver Memolla** . Tani në mos gaboj ajo tokë që pretendohet është pjesë e projektit të rrugës që u bë tek lagjja Çetë apo jo? Se ky është pretendimi që rruga është marrë nga investimi .

**Rezart Vogli** . Kaluam në këshill për shpronësim.

**Enver Memolla** . Nuk arrij të kuptoj është pjesë që e ka kapur investimi apo duhet ta shpronësojë bashkia për ta marrë për pronë publike nuk po kuptoj?

**Rezart Vogli** . Nuk është se kam informacion për këtë pjesë.

**Altin Tosku** . Një nga opsionet edhe pronari i tokës jep lekët është gati për shpronësim .



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Mukades Gixhari** . Atëherë meqë nuk kemi më diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

**MBYLLET MBLEDHJA**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 40<sup>oo</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 2 orë ; 09 min ; 45 sek, mbledhja hapet zyrtarisht në minutën 11;30 të regjistrimit të kësaj videoje, deri para kësaj mbledhja po regjistrohej jo zyrtarisht për shkak të një gabimi njerëzor të punonjësës IT).
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 50 (pesëdhjetë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**

**Sekretari i Këshillit  
Ervis Shera**